



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 194

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 15 nëntor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 108/2024, datë 17.10.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar..... 21153
Dekret i Presidentit nr. 390, datë 12.11.2024	Për shpallje ligji..... 21155
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 695, datë 13.11.2024	Për miratimin e masave mbështetëse, rregullave dhe procedurave për përfitim të masave mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme 21155
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 13.11.2024	Për përcaktimin e detyrave dhe të përgjegjësisë të Operatorit të Energjisë së Rinovueshme sh.a..... 21162
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 697, datë 13.11.2024	Për kalimin të bashkitë Vorë dhe Kurbin të njësive të banimit në ndërtesa (pallat)..... 21163
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 698, datë 13.11.2024	Për kalimin të Bashkia Tiranë të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) 21183
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 699, datë 13.11.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1095, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”..... 21183
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 13.11.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitheozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar..... 21184
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 702, datë 13.11.2024	Për disa shtesa në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar..... 21186

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 703, datë 13.11.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 101, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencive private të punësimit”.....	21187
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 13.11.2024	Për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, të llojit akademi, “ <i>American Academy of Technology Tirana</i> ”	21188
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 13.11.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 10, datë 7.1.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese’, të ndryshuar”	21188
Urdhër i Inspektoratit Qendror nr. 32, datë 12.11.2024	Për një ndryshim në rregulloren “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, miratuar me urdhrin nr. 25, datë 10.8.2018, të ndryshuar.....	21189
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe i ministrit të Brendshëm nr. 274, datë 16.5.2024	Për përcaktimin e procedurave, afateve, kriterëve dhe dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin e pastërtisë së figurës së punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të <i>Cannabis</i> -it apo të subjekteve të licencuara apo të lejuara, si dhe të kriterëve etiko-profesionale.....	21192



LIGJ
Nr. 108/2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011,
“PËR LEJET E MJEDISIT”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në tekstin e ligjit fjalët “inspektorati/inspektoratit shtetëror kompetent” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “struktura/strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit”.

Neni 2

Në nenin 25 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Tarifat për lejet e mjedisit të tipave A dhe B paguhen në llogarinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

3. Operatorët e instalimeve të tipave A dhe B paguajnë çdo vit një tarifë vjetore në llogarinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, duke u identifikuar nëpërmjet numrit të lejes (PN-së) përkatëse, duke përcjellë gjithmonë një kopje të mandatit të pagesës pranë AKM-së dhe ARM-së ku ndodhet instalimi.”.

2. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 26 shfuqizohet.

Neni 4

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Shfuqizimi dhe pezullimi i lejeve të mjedisit

1. Ministri, me propozim të AKM-së, për lejet e mjedisit të tipave A dhe B, pezullon ose shfuqizon lejen e mjedisit kur:

1/1. Në rast pezullimi:

a) paraqitet kërkesë nga vetë mbajtësi i lejes;

b) mbajtësi i lejes nuk përmbush kushtet e parashikuara në lejen e mjedisit;

c) mbajtësi i lejes nuk ka paguar tarifën e lejes së mjedisit dhe/apo gjobat administrative të vëna në bazë të këtij ligji apo të çdo akti tjetër normativ mjedisor.

1/2. Në rast shfuqizimi:

a) paraqitet kërkesë nga vetë mbajtësi i lejes;

b) mbajtësi i lejes nuk përmbush kushtet e parashikuara në lejen e mjedisit brenda afatit të pezullimit;

c) mbajtësi i lejes është dënua sipas legjislacionit në fuqi për një vepër penale në fushën e mjedisit apo ka kryer kundërvajtje administrative po në fushën e mjedisit;

ç) mbajtësi i lejes së mjedisit ka shkelur në mënyrë të përsëritur dispozitat e këtij ligji, fakt i cili ka sjellë vendosjen e gjobave administrative në përputhje me nenin 29 të këtij ligji;

d) mbajtësi i lejes nuk ka paguar tarifën e lejes së mjedisit dhe/apo gjobat administrative brenda afatit të pezullimit, të vendosura në bazë të këtij ligji apo të çdo akti tjetër normativ mjedisor.

2. Ministri miraton kërkesën për shfuqizimin e lejes së mjedisit sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni në rast se operatori ka marrë masat e nevojshme:

a) për të shmangur një rrezik ndotjeje nga veprimtaria e instalimit;

b) për të kthyer territorin e veprimtarisë në gjendjen e pranueshme të mjedisit, duke pasur parasysh gjendjen e këtij territori para se instalimi të fillonte veprimtarinë, verifikuar nga instancat inspektuese pranë AKM-së;

c) për të shlyer të gjitha detyrimet financiare.

3. Mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A apo B nga operatori i një instalimi, që:

a) ka çuar në rrezik ndotjeje të pakthyeshme të mjedisit nga veprimtaria e instalimit;



b) ka sjellë pamundësinë për të kthyer territorin e veprimtarisë në gjendje të pranueshme të mjedisit, duke pasur parasysh gjendjen e këtij territori para se instalimi të fillonte veprimtarinë, përbën shkak për heqjen e së drejtës së zotëruesit të lejes për t'u pajisur me leje të tjera mjedisore për një periudhë 50-vjeçare, si dhe për shfuqizimin e çdo lejeje tjetër mjedisore të vlefshme të të njëjtit zotërues.

4. Për rastet e parashikuara në pikën 3, në zonën e dëmtuar ndalohet lejimi i aktiviteteve të tjera që kanë impakt negativ në mjedis për sa kohë ajo sipërfaqe nuk është rikthyer në gjendjen e pranueshme të mjedisit.

5. Ministria i përcjell AKM-së aktin e pezullimit/shfuqizimit të lejes së mjedisit, me qëllim publikimin e tij në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave dhe njoftimin e operatorit.”.

Neni 5

Në nenin 29 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) zhvillimi i veprimtarisë, që është subjekt i një lejeje mjedisi të tipave A ose B, sipas përcaktimeve të këtij ligji:

i. pa lejen përkatëse të mjedisit të tipit A dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë;

ii. pa lejen përkatëse të mjedisit të tipit B dënohet me gjobë në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të masës së gjobës çdo ditë deri në plotësimin e detyrimit;

b) mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A apo B nga operatori i një instalimi:

i. për lejet e mjedisit të tipit A dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë;

ii. për lejet e mjedisit të tipit B dënohet me gjobë në vlerën nga 390 000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë,

duke u shtuar me vlerën 10 për qind të masës së gjobës çdo ditë deri në plotësimin e detyrimit;

c) mosinformimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga operatori, në përputhje me përcaktimin e pikës 3 të nenit 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të masës së gjobës çdo ditë deri në korrigjimin e mospërputhjes;

ç) mosrespektimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të nenit 30/1 dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të masës së gjobës çdo ditë deri në aplikimin për pajisjen me lejen e rishikuar.”.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Gjoha e dhënë në zbatim të këtij neni përbën titull ekzekutiv pas shterimit të ankimit administrativ, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative. Gjoha paguhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data kur është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë që përbën titull ekzekutiv. Në rast mosekzekutimi vullnetar, për ekzekutimin e saj ngarkohet zyra e përmbartimit sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 6

Pas nenit 30 shtohet neni 30/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 30/1

Dispozitë kalimtare

1. Operatori i pajisur me leje mjedisi të tipit A ose të tipit B, që nuk ka rishikuar apo ndryshuar kushtet e lejes ekzistuese të mjedisit, sipas parashikimeve të nenit 30 të ligjit, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ka detyrimin të aplikojë për rishikimin apo ndryshimin e kushteve të lejes mjedisore ekzistuese dhe pajisjen me leje mjedisi të rishikuar apo ndryshuar sipas kërkesave të këtij ligji, duke dorëzuar:

a) planin e përputhshmërisë me afatet përkatëse;

b) formularin e kërkesës për leje mjedisi të tipit A ose B;



c) pagesën e tarifës për ndryshim të kushteve të lejes së mjedisit;

ç) mandatpagesën për kryerjen e tarifave vjetore;

d) raportin për periudhën e fundit të vetëmonitorimit.

2. Pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, në rast se operatori nuk ka aplikuar për rishikimin apo ndryshimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit, përveç dënimit me gjobë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit kryesisht i propozon ministrit shfuqizimin e lejes.

3. Të gjitha subjektet e pajisura me një numër leje (PN), të gjeneruara nga sistemi për periudhën korrik-gusht 2022, i nënshtrohen kontrollit nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, e cila shqyrton plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe në vendimin nr. 419, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet përkatëse të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, i ndryshuar, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në rast se konstatohet mosplotësimi i kushteve të sipërpërmendura, struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit ndjek procedurat për shfuqizimin e numrit të lejes (PN) sipas parashikimeve të këtij ligji.

4. Akti “Leje mjedisi”, i lëshuar jo në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe për veprimtari të cilat nuk përfshihen në shtojcën 1, shfuqizohet.

5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit identifikojnë aktet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit kryesisht i propozon ministrit shfuqizimin e tyre.”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.10.2024.

Shpallur me dekretin nr. 390, datë 12.11.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 390, datë 12.11.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 108/2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, ‘Për lejet e mjedisit’, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM

Nr. 695, datë 13.11.2024

PËR MIRATIMIN E MASAVE MBËSHTETËSE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E MASAVE MBËSHTETËSE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E RINOVUESHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me propozimin e zëvendës-kryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë masat mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit e të erës dhe procedurat për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre, në mbështetje të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe objektivave të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.

2. Masat mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit e të erës jepen nëpërmjet një procesi



konkurrues, të hapur, transparent dhe jodiskriminues, i cili siguron besueshmëri për pjesëmarrësit dhe garanton dhënien e këtyre masave subjekteve që ofrojnë kushtet më të mira për sa i përket çmimit të energjisë, teknologjisë së përdorur dhe mënyrës së ndërtimit të impiantit.

3. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Masa mbështetëse”**, masat e parashikuara në pikën 5, të kreut I, të këtij vendimi që kanë si qëllim nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të diellit e të erës;

b) **“Autoriteti kontraktues”**, ministria përgjegjëse për energjinë;

c) **“Ministri”**, ministri përgjegjës për energjinë;

ç) **“Komision i posaçëm”**, komisioni i krijuar me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë, që përbëhet nga anëtarë specialistë, të cilët kanë njohuritë e duhura teknike, juridike dhe ekonomike;

d) **“Dokumentet e procesit konkurrues”**, dokumentet, të cilat hartohen nga komisioni i posaçëm i ofertave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, të cilat përcaktojnë formën, kriteret dhe procedurat e pjesëmarrjes, të shqyrtimit të ofertave dhe përzgjedhjes së ofertuesit më të mirë;

dh) **“Sigurimi i ofertës”**, dokumenti në formën e garancisë bankare të pakushtëzuar, që do të dorëzohet nga ofertuesi së bashku me ofertën;

e) **“Garancia e kontratës”**, dokumenti në formën e garancisë bankare të pakushtëzuar që do të dorëzohet nga ofertuesi i përzgjedhur përpara nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare;

ë) **“Marrëveshja e blerjes së energjisë (MBE)”** një lloj marrëveshjeje për mbështetje, ku një blerës i caktuar garanton blerjen fizike të detyrueshme të energjisë elektrike të gjeneruar nga prodhuesit për një çmim fiks, i cili do të dalë nga procesi konkurrues;

f) **“Ofertues i përzgjedhur”**, ofertuesi më i mirë i përzgjedhur sipas procedurës konkurruese për zhvillimin e projektit të përzgjedhur për prodhimin e energjisë elektrike prej burimeve të rinovueshme të erës dhe/ose diellit;

g) **“Operatori i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik”**, enti i ngarkuar për realizimin e detyrave të operatorit të energjisë së rinovueshme;

gj) **“Projekti”**, kapaciteti gjenerues i instaluar (në mw) për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit ose erës, i cili do të realizohet nga ofertuesi i përzgjedhur për përfitim

e masave mbështetëse, në bazë të procedurave konkurruese, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;

h) **“Shoqëria e projektit”**, shoqëria për qëllime të veçanta, që do të themelohet nga ofertuesi i përzgjedhur për realizimin e projektit;

i) **“Tarifa tavan”**, tarifa tavan për procedurën konkurruese që përcaktohet nga ministri, duke u bazuar në tarifën e miratuar nga ERE për të njëjtën teknologji, llojin dhe kapacitetin e impiantit, koston e investimit të teknologjisë së ngjashme, si dhe tarifave të rezultuara në ankande për kapacitete të ngjashme në Shqipëri dhe vende të tjera;

j) **“Kontratë për diferencën” (CfD)**, kontratë për mbështetje e rregulluar financiarisht ku enti i ngarkuar për të realizuar detyrat e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme i paguan prodhuesit me përparësi diferencën midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës kur çmimi i referencës është më i ulët se çmimi i garantuar dhe prodhuesi me përparësi i paguan diferencën Operatorit të Energjisë së Rinovueshme kur çmimi i referencës është më i lartë se çmimi i garantuar;

k) **“Kontrata për zhvillimin e projektit”**, kontrata për zhvillimin e projektit, e lidhur ndërmjet ofertuesit të përzgjedhur dhe autoritetit kontraktor;

l) **“Marrëveshja përfundimtare”**, marrëveshja e nënshkruar nga autoriteti kontraktor, ofertuesi i përzgjedhur dhe shoqëria e projektit, që konfirmon përmbushjen e të gjitha kushteve të përcaktuara në kontratën për zhvillimin e projektit dhe që e bën efektive;

ll) **“Procedura konkurruese me vendndodhje të përcaktuar”**, procedura konkurruese e organizuar sipas rregullave të parashikuara në kriteret II dhe III, të këtij vendimi, që mundëson dhënien e masave mbështetëse për impiante diellore dhe/ose nga era (eolike), me vendndodhje dhe kapacitet të instaluar, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

m) **“Procedura konkurruese me vendndodhje të papërcaktuar”**, procedura konkurruese e organizuar sipas rregullave të parashikuara në kreun IV, të këtij vendimi, që mundëson dhënien e masave mbështetëse për impiante nga burime të rinovueshme me kapacitet dhe vendndodhje të përcaktuar nga ofertuesi, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

4. Çdo term tjetër i përdorur në këtë vendim do të ketë kuptimin e dhënë në ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e



rinovueshme”, dhe të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

5. Me qëllim arritjen e objektivit kombëtar të përcaktuar në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën në mënyrën më efektive miratohen masat mbështetëse, si më poshtë vijon:

a) Kontrata sipas skemës mbështetëse, përcaktuar në ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, e cila mund të jetë në formën e marrëveshjes për blerjen e energjisë ose në formën e kontratës për diferencë dhe përcaktimeve në marrëveshjen që do të nënshkruhet me autoritetin kontraktor, me një kohëzgjatje maksimale prej 15 vitesh, duke filluar nga data e dhënies së certifikatës së përdorimit të projektit;

b) Në rastin e procedurës konkurruese me vendndodhje të përcaktuar, kalimin në administrim të autoritetit kontraktor të pasurive të paluajtshme për realizimin dhe shfrytëzimin e projektit, dhe vënien e tyre në dispozicion të shoqërisë së projektit për të gjithë kohëzgjatjen e tij, pa pagesë;

c) Garantimin e lidhjes dhe aksesit për përdorimin e rrjetit të transmetimit/shpërndarjes së energjisë së prodhuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) Garantimin nga autoriteti kontraktues të ndjekjes të të gjitha procedurave për marrjen e lejeve dhe autorizimeve të nevojshme për zbatimin dhe shfrytëzimin e projektit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Procesi për dhënien e masave mbështetëse duhet të garantojë:

a) arritjen e objektivit për përdorimin e energjisë së rinovueshme në përputhje me Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën brenda afatit kohor të caktuar;

b) dhënien e mbështetjes për blerjen e energjisë me koston më të ulët të mundshme dhe efektivitetin më të madh;

c) besueshmërinë e ofertave dhe realizimin e plotë të projektit;

ç) të qenët transparent, i hapur, jodiskriminues, objektiv, si dhe sigurimin e besimit të gjerë të investitorëve;

d) minimizimin e deformimeve të tregut të energjisë dhe lehtësimin e zhvillimit të tij.

II. ZHVILLIMI I PROCESIT PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTIT ME VENDNDODHJE TË PËRCAKTUAR QË DO TË PËRFITOJË MASAT MBËSHTETËSE

1. Ministri autorizon fillimin e procesit konkurrues për përzgjedhjen e projektit që do të përfitojë masat mbështetëse, duke përcaktuar të dhënat, si më poshtë vijon:

a) kapacitetin total që do të përfitojë masa mbështetëse;

b) llojin e teknologjisë së projektit;

c) vendndodhjen e projektit;

ç) kushtet për lidhjen me rrjetin, si dhe rregullat për balancimin dhe dispeçerimin;

d) dokumentet e nevojshme për zhvillimin e procesit konkurrues;

dh) kriteret e vlerësimit të ofertave;

e) afatin e përfundimit të projektit dhe të marrjes së certifikatës së përdorimit.

2. Ministri urdhëron ngritjen e komisionit të posaçëm, i cili ka këto kompetenca:

a) harton, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, dokumentet e procesit konkurrues, që specifikojnë mënyrën e zhvillimit të procesit konkurrues për përfitimin e masave mbështetëse;

b) harton kriteret të veçanta të aplikimit dhe të kualifikimit, bazuar në përcaktimet e pikës 6, të kreut II, të këtij vendimi;

c) harton metodologjinë e vlerësimit, e cila është pjesë e dokumenteve të procesit konkurrues;

ç) vlerëson ofertat e ofertuesve, bazuar në kriteret e kualifikimit të ofertës;

d) harton raportin përfundimtar të vlerësimit dhe e paraqet për miratim pranë ministrit;

dh) mund të angazhojë ekspertizë të veçantë vendase ose të huaj për të asistuar gjatë zhvillimit të procesit;

e) çdo funksion tjetër, bazuar në parashikimet e këtij vendimi;

ë) përgatit projekt marrëveshjet, që do të përmbyllen ndërmjet palëve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 24/2023 dhe të këtij vendimi.

3. Dokumentet e procesit konkurrues, ndër të tjera, përmbajnë:

a) ftesën për ofertë, e cila publikohet së paku në dy buletine të njoftimeve zyrtare dhe dy gazeta ndërkombëtare, si dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

b) udhëzuesin për pjesëmarrës në proces;



c) sigurimin e ofertës, i cili lëshohet nga një institucion bankar i besueshëm dhe në formatin e parashikuar në dokumentet e procesit konkurrues;

ç) afatin e vlefshmërisë së ofertës;

d) pagesën e tarifës së pjesëmarrjes në proces;

dh) kriteret bazë të aplikimit dhe të kualifikimit;

e) kriteret e vlerësimit të ofertave;

ë) garancinë e kontratës, e cila lëshohet nga një institucion bankar i besueshëm dhe siguron përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të marrëveshjes;

f) afatin e paraqitjes së ofertave, i cili, në çdo rast, nuk do të jetë më pak se 30 ditë;

g) zonat e ndaluara për zhvillim si rrjedhojë e statusit të zonës ose kapaciteteve teknike;

gj) përcaktimin e detajuar të rregullave të procedurës konkurruese, si proces me një fazë ose me disa faza, i cili mund të përfshijë një fazë parakualifikimi, kërkesa për kualifikim dhe kërkesa për propozime dhe kur gjykohet e justifikuar nga kompleksiteti i projektit, mund të përfshijë gjithashtu një fazë negociimi me kusht që të sigurohet trajtim i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e përzgjedhur;

h) rregullat për trajtimin e ofertave marxhinale dhe barazimit/eve ndërmjet ofertave të ndryshme.

4. Dokumentet e procesit konkurrues duhet të përfshijnë edhe parimet e mëposhtme, referuar marrëveshjes së mbështetjes:

a) tarifa duhet të jetë në euro/mwh;

b) tarifa duhet të jetë e nivelizuar dhe e pandryshuar për një periudhë deri në 15 vjet;

c) tarifa tavan nuk duhet jetë më e lartë se tarifa për të njëjtën teknologji, e miratuar nga ERE;

ç) forma e mbështetjes për prodhimin e energjisë të jetë bazuar në parashikimet e ligjit nr. 24/2023.

5. Dokumentet e procesit konkurrues duhet të përfshijnë parimet e mëposhtme, duke iu referuar pagesës sipas kontratës së blerjes së energjisë:

a) mënyra e kryerjes së pagesave dhe penaltitetet për pagesa të vonuara;

b) përcaktimi i një mekanizmi të duhur të sigurimit të pagesave të energjisë së prodhuar.

6. Për të siguruar që ofertuesit kanë kapacitetin e nevojshëm për realizimin e projektit, komisioni i posaçëm do të bazohet në kriteret bazë të aplikimit dhe të kualifikimit, në të cilat, ndër të tjera, përfshihen:

a) Kriteret ligjore:

i. ekstrakti tregtar i shoqërisë/apo bashkimit të shoqërive, i cili gjenerohet nëpërmjet sistemit nga institucioni. Në rast të bashkimit të shoqërive, ofertat e dorëzuara duhet të shoqërohen me një marrëveshje të përbashkët të ofertimit midis anëtarëve të bashkimit;

ii. vërtetime për shlyerjen e detyrimeve tatimore, pagesën e sigurimeve shoqërore, pagesën e detyrimeve të energjisë elektrike dhe të ujësjellës-kanalizimeve, dhe që shoqëria nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi, të cilat gjenerohen nëpërmjet sistemit nga institucioni;

iii. shoqëria apo bashkimi i shoqërive, si dhe drejtuesit e shoqërisë ofertuese ose e ndonjë prej shoqërive pjesëmarrëse në bashkimin e shoqërive ofertuese nuk duhet të jenë në ndjekje penale ose të jenë dënuar me një vendim të formës së prerë, të cilat gjenerohen nëpërmjet sistemit nga institucioni;

b) Kriteret financiare:

i. çdo dokumentacion të nevojshëm që vërteton gjendjen financiare të kompanisë dhe provon aftësinë e saj financiare për të realizuar projektin, sipas dokumenteve të procesit konkurrues;

ii. pasqyrat financiare, të audituara nga audituesit e licencuar, të tri viteve të fundit të veprimtarisë dhe të depozituara në organet tatimore ose, kur shoqëria ka më pak se tre vjet që është krijuar, për periudhën e ekzistencës së saj, si dhe çdo dokumentacion tjetër financiar që provon aftësitë financiare për të realizuar projektin e propozuar, shoqëruar me vërtetimin e licencës së audituesit;

iii. garancinë bankare në sigurimin e fondeve, e cila vlerësohet bazuar në përvojën e mëparshme në sigurimin e fondeve nga ana e ofertuesit ose çdo letër mbështetëse për financimin e projektit, marrë nga një institucion bankar i besueshëm;

c) Kriteret teknike:

i. shoqëria ofertuese ose bashkimi i shoqërive ofertuese duhet të kenë përvojë në të shkuarën për realizimin dhe shfrytëzimin e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve të rinovueshme prej diellit dhe/ose erës;

ii. në varësi të teknologjisë së përzgjedhur, modulet e paneleve diellore apo të turbinave eolike, inverterat dhe komponentët e tjerë elektrikë dhe elektromekanikë, si dhe lidhjet elektrike dhe ndërfaqësimet *software* dhe *hardware* të jenë në përputhje me kërkesat e rrjetit, si dhe të sigurojnë ofrimin e të dhënave reale metrike diellore dhe/ose



eolike lidhur me prodhimin e pritshëm vjetor të energjisë;

iii. aparaturat duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe kriteret e veçanta të përcaktuara nga komisioni i posaçëm;

ç) Kriteret e përvojës në fushën e energjisë së rinovueshme, në vlerësim të komisioni:

i. përvojë në ndërtimin e të paktën një centrali të një kapaciteti të ngjashëm;

ii. përvojë në ndërtimin dhe operimin e të paktën një centrali të prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve të rinovueshme;

iii. përvojë në ushtrimin e aktiviteteve të biznesit në Shqipëri;

d) Kriteri i besueshmërisë:

i. nuk duhet të jetë ose të ketë qenë objekt i penaliteteve ligjore dhe tatimore gjatë veprimtarisë së tij nga institucionet/agjencitë shqiptare dhe/ose prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian;

ii. nuk duhet të jetë i/e listuar që t'i kufizohet ushtrimi i aktivitetit në Shqipëri ose në vendet anëtare të Bashkimit Evropian;

dh) Kriteret e tjera të vlerësimit të ofertës:

i. ofertuesit duhet të ofrojnë një tarifë të nivelizuar 15-vjeçare në euro/mwh, e cila do të jetë pjesë e kriterëve të vlerësimit dhe në çdo rast nuk duhet jetë më e lartë se tarifa për të njëjtën teknologji, e miratuar nga ERE, sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues;

ii. ofertuesit duhet të garantojnë ndërtimin e kapaciteteve të tjera shtesë, përveç atyre të parashikuara si pjesë e masave mbështetëse, sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues.

7. Të drejtën për të aplikuar e ka:

a) çdo shoqëri ose bashkim shoqërish ofertuese, që plotëson kriteret e përcaktuara në dokumentet e procesit konkurrues, të parashikuara në këtë vendim;

b) çdo shoqëri ose bashkim shoqërish ofertuese që provon kapacitetin teknik, financiar dhe të besueshmërisë për të zhvilluar projektin e specifikuar, sipas kriterëve të vlerësimit, të përcaktuara në pikën 6, të kreut II, të këtij vendimi;

c) çdo shoqëri ose bashkim shoqërish ofertuese që paguan tarifën e pjesëmarrjes në procesin konkurrues, siç specifikohet në dokumentet e procesit konkurrues.

8. Komisioni do të vlerësojë vetëm ofertat e atyre ofertuesve që kanë paraqitur aplikimin e plotë sipas

këtij vendimi dhe dokumenteve të procesit, dhe që kanë paguar tarifën e pjesëmarrjes në proces.

9. Kostot e zhvillimit të procedurës së sipërpërmendur mbulohen nga ofertuesi i përzgjedhur fitues për ndërtimin e impiantit.

III. VLERËSIMI I OFERTAVE, NEGOCIMI DHE LIDHJA E MARRËVESHJES PËRFUNDIMTARE ME OFERTUESIN E PËRZGJEDHUR

1. Ofertat e ofertuesve do të vlerësohen sipas kriterëve të kualifikimit të ofertës të përcaktuara në pikën 6, të kreut II, të këtij vendimi, bazuar në një metodologji të vlerësimit të ofertave, të përbërë me pikë të ndara sipas secilit kriter.

2. Metodologjia e vlerësimit është pjesë e dokumenteve të procesit konkurrues.

3. Për secilin prej kriterëve të vlerësimit, ofertuesit duhet të sigurojnë dokumentet e nevojshme, sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues.

4. Ofertuesi me rezultatin më të lartë, sipas metodologjisë së vlerësimit të ofertës, shpallet ofertuesi i përzgjedhur.

5. Në përfundim të vlerësimit të ofertave, komisioni i posaçëm paraqet për miratim pranë ministrit raportin përfundimtar të vlerësimit.

6. Ministri autorizon negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare me ofertuesin e përzgjedhur, që përmban të gjitha elementet për zbatimin e suksesshëm të projektit.

7. Ofertuesi i përzgjedhur duhet të formojë një shoqëri për projektin për të hyrë në marrëveshje përfundimtare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

8. Ofertuesi i përzgjedhur duhet të zotërojë jo më pak se 51% të aksioneve të kapitalit në shoqërinë e projektit për të paktën tre vjet nga data e operimit tregtar.

9. Para nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare, ofertuesi i përzgjedhur/shoqëria e projektit duhet të paraqesë garancinë e kontratës, sipas përcaktimeve të dokumenteve të procesit konkurrues.

10. Ofertuesi i përzgjedhur duhet të garantojë respektimin e rregullave të tregut, si dhe të kërkesave teknike të rrjetit dhe balancimit të ngarkesës në Shqipëri.



IV. ZHVILLIMI I PROCESIT KONKURRUES PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTEVE ME PROCEDURË KONKURRUESE ME VENDNDODHJE TË PAPËRCAKTUAR

1. Ministri autorizon fillimin e procesit konkurrues për përzgjedhjen e projekteve me procedurë konkurruese me vendndodhje të papërcaktuar, duke përcaktuar të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) kapacitetin total që do të përfitojë masa mbështetëse;
- b) kapacitetin e instaluar që mund të ketë çdo projekt që do të përfitojë masat mbështetëse;
- c) llojin e teknologjisë së projekteve;
- ç) dokumentet e nevojshme për zhvillimin e procesit konkurrues;
- d) kriteret e vlerësimit të ofertave;
- dh) kërkesat për caktimin e vendndodhjes së projektit.

2. Ministri mund të përcaktojë organizimin e procedurës konkurruese me një fazë ose me dy faza, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

- a) në procesin me një fazë, komisioni i posaçëm harton dhe publikon të gjitha dokumentet e procedurës konkurruese në një fazë;
- b) në procesin me dy faza, komisioni përcakton listën e dokumenteve për fazën e kërkesave kualifikuese, që përfshijnë kërkesat teknike dhe financiare për parakualifikimin e ofertuesve. Në fazën e dytë komisioni përcakton kërkesat për fazën e propozimit, gjatë së cilës ofertuesit e parakualifikuar në fazën e parë do të ftohen për të paraqitur propozimin e detajuar teknik dhe financiar, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga komisioni.

3. Ministri urdhëron ngritjen e komisionit të posaçëm, i cili ka këto kompetenca:

- a) harton dokumentet e procesit konkurrues, që specifikojnë mënyrën e zhvillimit të procesit konkurrues për përfitimin e masave mbështetëse;
- b) harton kriteret e veçanta të aplikimit, parakualifikimit dhe të kualifikimit, bazuar në përcaktimet e pikës 6, të kreut II, të këtij vendimi;
- c) harton metodologjinë e vlerësimit të ofertave, e cila është pjesë e dokumenteve të procesit konkurrues;
- ç) vlerëson ofertat e ofertuesve bazuar në kriteret e parakualifikimit, kualifikimit dhe vlerësimit të ofertës;

d) harton raportin përfundimtar të vlerësimit dhe e paraqet për miratim pranë ministrit;

dh) çdo funksion tjetër, bazuar në parashikimet e këtij vendimi;

e) përgatit projekt marrëveshjet, që do të përmbillen mes palëve sipas parashikimeve të ligjit nr. 24/2023 dhe të këtij vendimi.

4. Dokumentet e procesit të posaçëm konkurrues, ndër të tjera, përmbajnë, si më poshtë vijon:

- a) ftesën për ofertë, e cila bëhet publike dhe publikohet së paku në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, si dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- b) udhëzuesin për pjesëmarrje në proces;
- c) sigurimin e ofertës, i cili lëshohet nga një institucion bankar apo financiar i besueshëm, në vlerën dhe formatin e parashikuar në dokumentet e procesit konkurrues;
- ç) afatin e vlefshmërisë së ofertës;
- d) pagesën e tarifës së pjesëmarrjes në proces;
- dh) kriteret bazë të aplikimit, parakualifikimit dhe të kualifikimit;

e) kriteret e vlerësimit të ofertave;

ë) zonat e ndaluara për zhvillim si rrjedhojë e statusit të zonës ose kapaciteteve teknike;

f) kur vlerësohet e nevojshme, kufizimin e pjesëmarrjes me disa projekte ose për kapacitete të caktuara të ofruara minimal dhe/ose maksimal.

5. Në dokumentet e procesit konkurrues duhet të përcaktohet gjithashtu se:

- a) tarifa e ofertuar nga subjektet duhet të jetë në euro/mwh dhe të jetë e nivelizuar dhe e pandryshuar për një periudhë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet;
- b) tarifa e ofertuar nga subjektet nuk duhet të jetë më e lartë se tarifa tavan e përcaktuar nga ministri;
- c) marrëveshja e mbështetjes do të aplikohet si marrëveshje për blerjen e energjisë ose si kontratë për diferencë, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 24/2023.

6. Për të siguruar që ofertuesit kanë kapacitetin e nevojshëm për realizimin e projektit, komisioni i posaçëm do të bazohet në kriteret bazë të aplikimit dhe të kualifikimit, në të cilat, ndër të tjera, përfshihen:

- a) Kriteret ligjore:
 - i. në rast të bashkimit të shoqërive, ofertat e dorëzuara duhet të shoqërohen me një marrëveshje



të përbashkët të ofertimit ndërmjet anëtarëve të bashkimit;

ii. vërtetime për shlyerjen e detyrimeve tatimore, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe që shoqëria nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

iii. shoqëria apo bashkimi i shoqërive, si dhe drejtuesit e shoqërisë ofertuese ose e ndonjë prej shoqërive pjesëmarrëse në bashkimin e shoqërive ofertuese nuk duhet të jenë në ndjekje penale ose të jenë dënuar me një vendim të formës së prerë;

b) Kriteret financiare:

i. çdo dokumentacion i nevojshëm që vërteton gjendjen financiare të kompanisë dhe provon aftësinë e saj financiare për të realizuar projektin, sipas dokumenteve të procesit konkurrues;

ii. pasqyrat financiare, të audituara nga audituesit e licencuar, të tri viteve të fundit të veprimtarisë dhe të depozituara në organet tatimore ose, kur shoqëria ka më pak se tre vjet që është krijuar, për periudhën e ekzistencës së saj, si dhe çdo dokumentacion tjetër financiar që provon aftësitë financiare për të realizuar projektin e propozuar, shoqëruar me vërtetimin e licencës së audituesit;

c) Kriteret teknike:

i. shoqëria ofertuese ose bashkimi i shoqërive ofertuese duhet të provojnë vetë ose me anë të një marrëdhënieje bashkëpunimi përvojë në të shkuarën për realizimin dhe/ose shfrytëzimin e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve të rinovueshme, në përputhje me dokumentet e procesit konkurrues;

ii. në varësi të teknologjisë së përzgjedhur, modulet e paneleve diellore apo të turbinave eolike, inverterat dhe komponentët e tjerë elektrikë dhe elektromekanikë, si dhe lidhjet elektrike dhe ndërfaqësimet software dhe hardware të jenë në përputhje me kërkesat e rrjetit, si dhe të sigurojnë ofrimin e të dhënave reale metrike diellore dhe/ose eolike, lidhur me prodhimin e pritshëm vjetor të energjisë;

iii. aparaturat duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe kriteret e veçanta të përcaktuara nga komisioni i posaçëm;

c) Kriteret tjera të vlerësimit të ofertës:

i. ofertuesit duhet të ofrojnë një tarifë të nivelizuar 15-vjeçare në euro/mwh, e cila do të jetë pjesë e kriterëve të vlerësimit;

ii. ofertuesit duhet që në momentin e aplikimit të kenë paraqitur dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon

marrëdhënien afatgjatë mbi tokën/pasurinë që do të përdoret për ndërtimin dhe operimin e burimit gjenerues;

iii. ofertuesi duhet të paraqesë propozimin për lidhjen me rrjetin, duke deklaruar se do të mbulojë me fondet e saj çdo kosto për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për lidhjen e rrjetit deri në pikën e autorizuar nga operatori i rrjetit.

d) Kriteret për përcaktimin e vendndodhjes:

Vendndodhja e propozuar duhet të jetë në tokë të pafrytshme ose toka që janë jo të kategorizuara si të frytshme.

7. Të drejtën për të aplikuar e ka çdo shoqëri ose bashkim shoqërish ofertuese që paguan tarifën e pjesëmarrjes në procesin konkurrues, sipas kushteve të specifikuara në dokumentet e procesit konkurrues.

8. Ofertat e ofertuesve do të vlerësohen sipas kriterëve të kualifikimit të ofertës, të përcaktuara në pikën 5, të këtij kreu, bazuar në një metodologji të vlerësimit të ofertave, të përbërë me pikë të ndara sipas secilit kriter, që është pjesë e dokumenteve të procesit konkurrues.

9. Metodologjia e vlerësimit të ofertave duhet të parashikojë që çmimi i ofruar nga subjektet për blerjen e energjisë të zërë së paku 50% të pikëve.

10. Për secilin prej kriterëve të vlerësimit, ofertuesit duhet të sigurojnë dokumentet e nevojshme, sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues.

11. Kur kapaciteti i përbashkët i ofertave që përmbushin kriteret e kualifikimit, sipas këtij vendimi, është më i ulët sesa kapaciteti i ofruar nga ministria, komisioni i posaçëm shpall të gjithë ofertuesit që përmbushin kriteret e kualifikimit si ofertues të përzgjedhur.

12. Kur kapaciteti i përbashkët i ofertave që përmbushin kriteret e kualifikimit është më i lartë sesa kapaciteti i ofruar nga ministria, komisioni i posaçëm bën përlogaritjen e pikëve për ofertuesit dhe renditjen e tyre sipas rezultatit më të lartë, duke shpallur edhe ofertuesit e përzgjedhur.

13. Në përfundim të vlerësimit të ofertave, komisioni i posaçëm paraqet për miratim pranë ministrit raportin përfundimtar të vlerësimit.

14. Ministri autorizon negocimin dhe nënshkrimin e kontratës për zhvillimin e projektit me ofertuesit e përzgjedhur, që përmban të gjitha elementet për zbatimin e suksesshëm të projektit.



15. Ofertuesi i përzgjedhur duhet të formojë një shoqëri për projektin për të hyrë në marrëveshje përfundimtare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

16. Para nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare, ofertuesi i përzgjedhur/shoqëria e projektit duhet të paraqesë garancinë e kontratës, sipas përcaktimeve të dokumenteve të procesit konkurrues.

17. Ofertuesi i përzgjedhur duhet të garantojë respektimin e rregullave të tregut, si dhe të kërkesave teknike të rrjetit dhe balancimit të ngarkesës në Shqipëri.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

20	Objekti/Pallati BN.6.02	3+1	20	5	3					100.05	117.76	0.00	117.76
Kati 6										400.13	462.84	0.00	462.84
21	Objekti/Pallati BN.6.02	3+1	21	6	2					99.57	117.38	0.00	117.38
22	Objekti/Pallati BN.6.02	3+1	22	6	2					100.24	113.82	0.00	113.82
23	Objekti/Pallati BN.6.02	3+1	23	6	3					100.27	113.88	0.00	113.88
24	Objekti/Pallati BN.6.02	3+1	24	6	3					100.05	117.76	0.00	117.76
Kati 7										400.13	462.84	0.00	462.84
25	Objekti/Pallati BN.6.02	3+1	25	7	2					99.57	117.38	0.00	117.38
26	Objekti/Pallati BN.6.02	3+1	26	7	2					100.24	113.82	0.00	113.82
27	Objekti/Pallati BN.6.02	3+1	27	7	3					100.27	113.88	0.00	113.88
28	Objekti/Pallati BN.6.02	3+1	28	7	3					100.05	117.76	0.00	117.76



Objekti/Pallati BN.6.03										4,504.91	5,258.78	-	5,258.78
Kati 1										493.62	584.30	0.00	584.30
1	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	1	1	4					94.07	112.85	0.00	112.85
2	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	2	1	4					58.27	67.42	0.00	67.42
3	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	3	1	4					93.49	111.88	0.00	111.88
4	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	4	1	5					94.64	111.88	0.00	111.88
5	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	5	1	5					58.21	67.57	0.00	67.57
6	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	6	1	5					94.94	112.70	0.00	112.70
Kati 2										493.62	584.30	0.00	584.30
7	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	7	2	4					94.07	112.85	0.00	112.85
8	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	8	2	4					58.27	67.42	0.00	67.42
9	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	9	2	4					93.49	111.88	0.00	111.88
10	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	10	2	5					94.64	111.88	0.00	111.88
11	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	11	2	5					58.21	67.57	0.00	67.57
12	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	12	2	5					94.94	112.70	0.00	112.70
Kati 3										498.61	584.30	0.00	584.30
13	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	13	3	4					95.3	112.75	0.00	112.75
14	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	14	3	4					58.6	67.52	0.00	67.52
15	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	15	3	4					95.45	111.88	0.00	111.88
16	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	16	3	5					94.79	111.88	0.00	111.88
17	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	17	3	5					58.73	67.52	0.00	67.52
18	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	18	3	5					95.74	112.75	0.00	112.75
Kati 4										498.61	584.30	0.00	584.30
19	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	19	4	4					95.3	112.75	0.00	112.75
20	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	20	4	4					58.6	67.52	0.00	67.52
21	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	21	4	4					95.45	111.88	0.00	111.88
22	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	22	4	5					94.79	111.88	0.00	111.88
23	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	23	4	5					58.73	67.52	0.00	67.52
24	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	24	4	5					95.74	112.75	0.00	112.75
Kati 5										498.61	584.30	0.00	584.30
25	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	25	5	4					95.3	112.75	0.00	112.75
26	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	26	5	4					58.6	67.52	0.00	67.52
27	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	27	5	4					95.45	111.88	0.00	111.88
28	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	28	5	5					94.79	111.88	0.00	111.88
29	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	29	5	5					58.73	67.52	0.00	67.52
30	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	30	5	5					95.74	112.75	0.00	112.75



Kati 6									
31	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	31	6	4	504.40	584.32	0.00	584.32
32	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	32	6	4	59.35	67.62	0.00	112.66
33	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	33	6	4	96.62	111.88	0.00	67.62
34	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	34	6	5	95.91	111.88	0.00	111.88
35	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	35	6	5	59.17	67.62	0.00	111.88
36	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	36	6	5	96.9	112.66	0.00	67.62
Kati 7									
37	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	37	7	4	504.40	584.32	0.00	112.66
38	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	38	7	4	59.35	67.62	0.00	112.66
39	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	39	7	4	96.62	111.88	0.00	67.62
40	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	40	7	5	95.91	111.88	0.00	111.88
41	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	41	7	5	59.17	67.62	0.00	111.88
42	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	42	7	5	96.9	112.66	0.00	67.62
Kati 8									
43	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	43	8	4	504.40	584.32	0.00	112.66
44	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	44	8	4	59.35	67.62	0.00	112.66
45	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	45	8	4	96.62	111.88	0.00	67.62
46	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	46	8	5	95.91	111.88	0.00	111.88
47	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	47	8	5	59.17	67.62	0.00	111.88
48	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	48	8	5	96.9	112.66	0.00	67.62
Kati 9									
49	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	49	9	4	508.64	584.32	0.00	112.66
50	Objekti/Pallati BN.6.03	1+1	50	9	4	59.35	67.62	0.00	112.66
51	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	51	9	4	96.62	111.88	0.00	67.62
52	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	52	9	5	95.93	111.88	0.00	111.88
53	Objekti/Pallati BN.6.03	hapesire e perbashket	53	9	5	63.97	68.4	0.00	111.88
54	Objekti/Pallati BN.6.03	3+1	54	9	5	96.39	111.88	0.00	68.40



“Rindërtimi i njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonën e re për zhvillim Laç 1.2, Paketa B, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin”									
NR	Emërtimi i objektit	Tipologjia	NR APART	KATI	SHKALLA	SIP Neto (m ²)	SIP totale (m ²)	SIP Perbashket (m ²)	SIP Totale perfshire sip e perbashket (m ²)
Objekti O-8									
Sipërfaqe totale banimi									
Sipërfaqe totale parkimi									
Objekti O-8									
“Rindërtimi i njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonën e re për zhvillim Laç 1.2, Paketa B, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin”									
Objekti O-8 - Njesi banimi									
Totali Njesi Banimi (O-8)									
Objekti O-8						1,388.07	1,588.05	224.94	1,812.99
Objekti O-8						1,388.07	1,588.05	224.94	1,812.99
Kati 1									
1	GODINA 8	1+1	1	1	1	59.43	68.43	9.63	78.06
2	GODINA 8	3+1	2	1	1	96.2	109.15	15.36	124.51
3	GODINA 8	3+1	3	1	2	95.75	108.72	15.58	124.3
4	GODINA 8	1+1	4	1	2	56.04	65.7	9.41	75.11
5	GODINA 8	2+1	5	1	3	77.09	87.63	12.35	99.98
6	GODINA 8	2+1	6	1	3	77.76	89.72	12.65	102.37
Kati 2									
7	GODINA 8	1+1	1	2	1	59.55	68.43	9.63	78.06
8	GODINA 8	3+1	2	2	1	96.36	109.15	15.36	124.51
9	GODINA 8	3+1	3	2	2	95.79	108.72	15.58	124.3
10	GODINA 8	1+1	4	2	2	56.12	65.7	9.41	75.11
11	GODINA 8	2+1	5	2	3	77.2	87.63	12.35	99.98
12	GODINA 8	2+1	6	2	3	77.88	89.72	12.65	102.37
Kati 3									
13	GODINA 8	1+1	1	3	1	59.55	68.43	9.63	78.06
14	GODINA 8	3+1	2	3	1	96.36	109.15	15.36	124.51
Objekti O-8									
15	GODINA 8	3+1	3	3	2	95.79	108.72	15.58	124.3
16	GODINA 8	1+1	4	3	2	56.12	65.7	9.41	75.11
17	GODINA 8	2+1	5	3	3	77.2	87.63	12.35	99.98
18	GODINA 8	2+1	6	3	3	77.88	89.72	12.65	102.37

**VENDIM****Nr. 698, datë 13.11.2024**

**PËR KALIMIN TE BASHKIA TIRANË
TË NJËSIVE TË BANIMIT NË
NDËRTESE (PALLAT)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Tiranë të 28 (njëzet e tetë) apartamenteve në 1 (një) ndërtesë me njësi banimi (pallat), përkatësisht, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

GODINA 1D, ZONA E RE ZHVILLIMORE KOMBINAT

Lista e Inventarit të Objektivit Kolektiv të Përfunduar në Zonën "Kombinat" (Kolauduar)

Nr.	Objekti	Ap.1+1	Ap.2+1	Ap.3+1	Total Apartamente (Nr)	Vlera e studimit projektimit	Vlera e mbikqyrjes së punimeve	Vlera e kolaudimit të punimeve	Vlera e Situacionit Përfundimtar (Ndërtim+Montim)	Vlera Totale (Ndërtim+Studim Projektim+Mbikqyrje+Kolaudim)	Sipërfaqe Total Ndërtimi (Sip. Total Banimi + Sip. Kati Përde + Sip. Parkimi + Sip. Taraca) / (m2)	Sipërfaqe Banimi Apartamente (m2)	Sipërfaqe e Njësive të Shërbimit	Sipërfaqja (kat -1)
1	Godina 1D	3	21	4	28	4,647,000	2,176,600	78,500	215,924,991.64	222,827,091.64	4980.90	3405.80	419.3	1,155.8

VENDIM**Nr. 699, datë 13.11.2024**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 1095, DATË
24.12.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
KËRKESAVE THELBËSORE NË
FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, pika 2, 37, pika 3, 50, pika 2, 54, pika 2, 84, pika 2, 91, pika 3, dhe 114, pika 2, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajrëor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kërkesat thelbësore në fushën e aviacionit civil, që i bashkëlidhen vendimit nr. 1095, datë

24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) fjalia e parë, e pikës 2, të nenit 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për sa u përket zhurmës dhe shkarkimeve, avionët dhe motorët e tyre, helikat, pjesët dhe pajisjet e përdaluar të tyre, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, të përfshira në ndryshimin 13, të vëllimit I, në ndryshimin 10, të vëllimit II, dhe në ndryshimin 1, të vëllimit III, të aneksit 16, të Konventës së Çikagos, të gjitha të zbatueshme nga 1 janari 2021.”;

b) në nenin 67 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. në titullin e nenit 67 hiqen fjalët “(ky nen do të zbatohet kur Shqipëria të jetë asociuar në EASA, sipas parashikimeve të marrëveshjes shumëpalëshe)”;

ii. pika 1, e këtij neni, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Certifikatat e lëshuara nga EASA-ja apo autoriteti kompetent i ndonjë shteti anëtar dhe deklaratat e bëra nga persona fizikë dhe juridikë, në

¹ Ky vendim është përafëruar plotësisht me rregulloren (BE) nr. 2021/1087, e datës 7 prill 2021, që ndryshon rregulloren (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për sa i takon përditësimin të referencave në parashikimet e

Konventës së Çikagos. Numri CELEX: C/2021/2102, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 236, datë 5.7.2021, faqe 1–2.



përputhje me rregulloren e BE-së nr. 2018/1139, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, dhe me aktet zbatuese dhe të deleguara, të cilat janë miratuar në bazë të saj, do të jenë të vlefshme dhe të njohura nga Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar pa kërkesa apo vlerësime të mëtejshme.”;

iii. pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Për njohjet e bëra nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në bazë të këtij neni, për rastet e përmendura në pikat 2 dhe 3, Autoriteti i Aviacionit Civil ndërmerr masa për të vendosur procedura komunikimi të vazhdueshme me autoritetin kompetent mbikëqyrës të personit fizik ose juridik, në mënyrë që të përditësohet për statusin e certifikimit apo deklarimit.”;

c) në nenin 70 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

i. në titullin e nenit 70 hiqen fjalët “(ky nen do të zbatohet kur Shqipëria të jetë asociuar në EASA, sipas parashikimeve të marrëveshjes shumëpalëshe)”;

ii. pas pikës 4 shtohen pikat 5 dhe 6, me këtë përmbajtje:

“5. Autoriteti i Aviacionit Civil reagon, pa vonesa të panevojshme, për një problem urgjent të sigurisë, brenda fushës së zbatimit të këtyre kërkesave thelbësore, duke përcaktuar masat korrigjuese, që duhet të ndërmerren nga personat fizikë dhe juridikë, në lidhje me të cilët vepron si autoriteti kompetent dhe duke i shpërndarë informacionet përkatëse këtyre personave, përfshirë direktivat ose rekomandimet, kur kjo është e nevojshme për të mbrojtur objektivat e përcaktuar në nenin 1, të këtyre kërkesave thelbësore. Autoriteti i Aviacionit Civil, gjithashtu, mund të nxjerrë buletinin e sigurisë, që përmban informacione jo të detyrueshme ose rekomandime të adresuara personave të tjerë fizikë dhe juridikë, të përfshirë në aktivitetet e aviacionit.

6. Për raste, të cilat nuk rregullohen nga aktet e dala, në zbatim të këtij vendimi apo për rastet kur mund të cenohet siguria në operim (*safety*), Autoriteti i Aviacionit Civil mund të nxjerrë masa të detyrueshme për zbatim. Për rastet, të cilat nuk rregullohen nga aktet e dala, në zbatim të këtij vendimi, masat përkatëse do të jenë në fuqi deri në plotësimin e legjislacionit përkatës, por jo më shumë se 1 (një) vit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 701, datë 13.11.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 54, DATË 5.2.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURËS E TË MËNYRËS SË
DHËNIES ME QIRA, ENFITEOZË APO
KONTRATA TË TJERA TË PASURISË
SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në ndarjen I bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) pas shkronjës “g”, të pikës 5, shtohet shkronja “gj”, me këtë përmbajtje:

“gj) dhënia me qira ose enfiteozë e pasurive shtetërore subjekteve private në rastin kur Komiteti i Investimeve Strategjike ka miratuar statusin “Investim strategjik” për projektin e investimit me potencial strategjik, si dhe masën mbështetëse për vënien në dispozicion të pasurisë shtetërore. Ndryshimet e mëvonshme në kontratë nuk i nënshtrohen kufizimeve të shkronjës “e”, të pikës 5, të kësaj ndarjeje.”;



b) nëndarja “i”, e shkronjës “a”, të pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Pasuritë shtetërore që ka në administrim, me sipërfaqe deri në 200 m², sipas pikës 2, të këtij vendimi, përveç truallit të lirë dhe tokës së pafrytshme.”;

c) pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Dhënia në përdorim e pasurive kulturore tek të tretët bëhet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në përputhje me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.”.

2. Pas fjalisë së parë, të shkronjës “c”, të pikës 9, të ndarjes II, shtohen fjalitë, me këtë përmbajtje:

“Në rast se verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në konkurrim në formën e deklaratave ose vetëdeklarimeve është i pamundur të realizohet nga Komisioni nëpërmjet platformës elektronike “e-Albania” ose nëpërmjet komunikimit e ndërveprimit ndërinstitucional, atëherë u kërkohej me shkresë subjekteve në konkurrim të paraqesin dokumentacionin provues. Subjektet duhet që brenda 10 (dhjetë) ditëve të sjellin dokumentacionin e marrë nga institucionet shtetërore përkatëse, në formë elektronike ose fizike. Në këtë rast, afati 15-ditor i shqyrtimit rifillon nga mbarimi i afatit 10-ditor të dorëzimit të dokumentacionit të sipërpërmendur.”.

3. Në ndarjen V bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) dy fjalitë e fundit të pikës 2 zëvendësohen me fjalitë, me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur propozimi për kontratat e qirasë ose të enfiteozës vjen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, propozimi për Këshillin e Ministrave bëhet nga ministri përgjegjës për ekonominë. Ministria përgjegjëse për ekonominë kryen të gjitha procedurat sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Propozimi shoqërohet me projektkontratën e negociuar ndërmjet subjektit dhe ministrisë përgjegjëse për ekonominë, bazuar në kontratën tip të këtij vendimi. Propozimi përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar, të përcaktuar në këtë vendim. Në rast se ky dokumentacion nuk është i plotë ose ka mangësi kthehet për plotësim ose rishqyrtim në institucionin propozues.”;

b) shkronja “a”, e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Për kontratat e qirasë ose të enfiteozës, me nivele investimi mbi 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, me qëllim ushtrimin e veprimtarive në fushën

e sportit, kulturës, turizmit, inovacionit apo që ndikojnë për zgjidhjen e problemeve sociale ose për strehimin dhe përkujdesjen e të moshuarve;”;

c) pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1 Ministria përgjegjëse për ekonominë propozon në Këshillin e Ministrave dhënien me qira/enfiteozë të pasurisë shtetërore pa konkurrim dhe me tarifën simbolike 1 euro/kontrata për projekte për të cilat Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) ka miratuar vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore, si masë mbështetëse për realizimin e investimit, sipas ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ka ngarkuar ministrinë përgjegjëse për ekonominë për lidhjen e kontratës me tarifën simbolike 1 euro/kontrata.”;

ç) në pikën 4, togfjalëshi “... në konkurrim ...” hiqet.

4. Fjalja e dytë, e shkronjës “b”, të pikës 3, të ndarjes IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ministria përgjegjëse për ekonominë bën përmbledhësen vjetore në rang vendi dhe një kopje të saj ia dërgon ministrisë përgjegjëse për financat.”.

5. Në ndarjen VIII bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 6, fjalët “...”, në përputhje me shkronjën “b”, të nenit 3, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar...” zëvendësohen me “... sipas kriterëve dhe procedurës së parashikuar në pikën 4, të kësaj ndarjeje ...”;

b) paragrafi i parë, i pikës 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Në rast se në pasuritë shtetërore, për të cilat është lidhur një kontratë qiraje/enfiteoze, ekzistojnë objekte apo ndërtime ekzistuese, të cilat nuk mundësojnë përmbushjen e objektit të kontratës, subjektit qiramarrës/enfiteozëmarrës i lind e drejta e paraqitjes së kërkesës pranë përfaqësuesit të pronës shtetërore për shembjen e tyre, nëse është parashikuar në projektin, pjesë e kontratës.

Kur pasuria shtetërore, që përmban objekte apo ndërtesa, shtrihet në gjurmën e projekteve për të cilat është miratuar leja e zhvillimit në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, objektet dhe ndërtesat ekzistuese të ndodhura në këtë pasuri shemben në funksion të zhvillimit të projektit, në përputhje me procedurat e parashikuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.



Shpenzimet e shembjes, si dhe vlera kontabël e këtyre objekteve apo ndërtesave përballohen nga subjekti zhvillues i projektit. Në këto shpenzime të shembjes përfshihen edhe pagesat për audituesit ligjorë ose ekspertë të tjerë të pavarur të specializuar dhe të licencuar, të emëruar nga subjekti shtetëror qiradhënës/enfiteozëdhënës për të gjithë procedurën e zhvilluar për këtë qëllim.

Përcaktimi i vlerës kontabël bëhet nga eksperti kontabël i miratuar/audituesi ligjor i emëruar për këtë qëllim nga ministri përgjegjës për ekonominë. Kur eksperti kontabël i miratuar/audituesi ligjor konstaton se për objektet apo ndërtesat në vlerësim nuk ka vlerë kontabël të përcaktuar, i kërkon ministrit përgjegjës për ekonominë emërimin e një eksperti vlerësues të pasurive të paluajtshme. Pas dorëzimit të raportit nga ana e ekspertit kontabël të miratuar/audituesit ligjor, ministri përgjegjës për ekonominë autorizon kryerjen e pagesës së vlerës përkatëse kontabël të përcaktuar nga eksperti kontabël i miratuar/audituesi ligjor, sipas rastit, që do të përballohet nga subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës në llogarinë e ministrisë përgjegjëse për ekonominë.”;

c) paragrafi dytë, i pikës 7, shfuqizohet.

6. Kudo në përmbytjen e vendimit, pas fjalëve “... ekspert kontabël i miratuar ...” shtohen “... / auditues ligjor, sipas rastit ...”.

II. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 702, datë 13.11.2024

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN
NR. 77, DATË 28.1.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KONTRIBUTET
E DETYRUESHME DHE PËRFITIMET
NGA SISTEMI I SIGURIMEVE
SHOQËRORE DHE SIGURIMI I
KUJDESIT SHËNDETËSOR”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 10, 11, 13, 15 e 99, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë

24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 6, 8 e 9, të ligjit nr. 9136, datë 1.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës “j”, të pikës 1, të kreut I, shtohet shkronja “k”, me këtë përmbytje:

“k) Nxënësit punëmarrës, që ndjekin arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë në kualifikimet e niveleve 2 deri në 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe që nënshkruajnë një kontratë pune për mësimin e profesionit, me pagesë mujore, për të cilët paguhen kontribute nga punëdhënësi në nivelin minimal, vetëm për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, për kohëzgjatjen e kontratës.”.

2. Pas pikës 22, të kreut III, shtohet pika 23, me këtë përmbytje:

“23. Për nxënësin punëmarrës, që ndjek arsimin dhe formimin profesional, në formën e dyfishtë në kualifikimet e niveleve 2 deri në 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, që nënshkruan një kontratë pune për mësimin e profesionit me pagesë, kontributi i detyrueshëm për aksidente në punë dhe sëmundjet profesionale është në vlerën 0.3% të pagës bruto minimale në shkallë vendi dhe përballohet nga kompania trajnuese për arsimin e dyfishtë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 703, datë 13.11.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 101, DATË 23.2.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË
FUNKSIONIMIT TË AGJENCIVE
PRIVATE TË PUNËSIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 101, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencive private të punësimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit publikon në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve aktin e miratimit, refuzimit dhe revokimit të licencës.”.

2. Në pikën 4, pas fjalëve “... shtetasve shqiptarë jashtë shtetit ...” shtohen fjalët “... dhe të shtetasve të huaj brenda vendit ...”.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Pjesë e dosjes administrative të një punëkërkuar është dokumentacioni për të dhënat identifikuese të punëkërkuarit dhe të subjektit punëdhënës.”.

4. Pas pikës 6 shtohen pikat 6.1 dhe 6.2, me këtë përmbajtje:

“6/1. Agjencia mban evidenca për ndërmjetësimet e kryera, duke përfshirë dokumentet, si më poshtë vijon:

a) regjistrin, me numrin identifikues përkatës për çdo të ndërmjetësuar;

b) dokumentin identifikues të ndërmjetësuarit;

c) regjistrin me të dhënat identifikuese të subjekteve tregtare përkatëse, që kanë punësuar të ndërmjetësuarin/it.

6/2. Agjencia, gjatë gjithë aktivitetit të saj, duhet të ketë një minimum rezervë sigurie të ngurtësuar, jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë të provueshme

nëpërmjet një dokumenti të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari, që mund të përdoret për kompensimet ndaj të tretëve.”.

5. Në pikën 7, pas fjalëve “... trajtim të barabartë për të gjithë punëkërkuarët ...” shtohen “... dhe u nënshtrohet parimeve të përgjithshme, si: parimi i respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut e të drejtave të punës, i ligjshmërisë, i mosdiskriminimit, i sjelljes etike dhe i profesionalizmit, i konfidencialitetit dhe i mbrojtjes së të dhënave personale ...”.

6. Në pikën 8 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Fjala “... pasurisë ...” zëvendësohet me “... sigurisë ...”;

b) Në fund të pikës 8 shtohen fjalët “... si dhe çdo e drejtë e parashikuar nga legjislacioni kombëtar për çështjet e punësimit.”.

7. Pas pikës 12 shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

“12/1. Agjencia, çdo 6 (gjashtë) muaj, njofton ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit për strukturën, veprimtarinë e vet dhe për ruajtjen e çdo kriteri të licencimit.”.

8. Në fund të pikës 13, fjalët “... ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për revokimin e licencës ...” zëvendësohen me “... ministri përgjegjës për çështjet e punësimit revokon licencën ...”.

9. Pas pikës 18 shtohet pika 18/1, me këtë përmbajtje:

“18/1. Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive publikojnë në faqet e tyre zyrtare të internetit të dhënat për agjencitë private të punësimit të licencuara.”.

II. Dispozitë kalimtare

Për licencat aktive, për nënkategorinë X.2.A, të dhëna para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, brenda afatit kohor prej 120 (njëqind e njëzet) ditësh kalendarike, subjektet kanë detyrimin të aplikojnë për ndryshimet e nevojshme, në përputhje me kriteret e reja, me qëllim mbajtjen e licencës, në të kundërt ajo do të revokohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 704, datë 13.11.2024

PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, JOPUBLIK, TË LLOJIT AKADEMI, “AMERICAN ACADEMY OF TECHNOLOGY TIRANA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19, 30 dhe 31, pika 1, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, të llojit akademi, “*American Academy of Technology Tirana*”, në vijim Akademia “*American Academy of Technology Tirana*” (AATI), në emër të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan “*Harry T. Fultz*”, i cili ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Akademia “*American Academy of Technology Tirana*” organizohet në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Teknologjisë dhe ka në përbërje njësitë bazë, si më poshtë vijon:

- a) Departamentin e Inxhinierisë Elektrike;
- b) Departamentin e Teknologjisë së Informacionit;
- c) Qendrën Kërkimore Shkencore.

3. Akademia “*American Academy of Technology Tirana*” ofron programe të studimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

4. Akademia “*American Academy of Technology Tirana*” fillon veprimtarinë vetëm pas nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë.

5. Akademia “*American Academy of Technology Tirana*” duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Statuti i Akademisë “*American Academy of Technology Tirana*” miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontroll periodik të ligjshmërisë në institucion, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

8. Çdo ndryshim i njësisë kryesore të Akademisë “*American Academy of Technology Tirana*” miratohet me

urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan “*Harry T. Fultz*” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 705, datë 13.11.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 10, DATË 7.1.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR LICENCIMIN DHE INSPEKTIMIN E VEPRIMTARIVE ME BURIME TË RREZATIMEVE JONIZUESE’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren, që i bashkëlidhet vendimit nr. 10, datë 7.1.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese”, të ndryshuar”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në rubrikën “Format shpjegues, në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë, përdorim, generatorë me rreze X”, në fjalinë e fundit të pikës 8, fjalët “... siç përcaktohet në faqen zyrtare ...” zëvendësohen me “... ose t’i referohen listës së ekspertëve të njohur nga KMR-ja.”.

2. Në rubrikën “Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë, përdorim, burime radioaktive”, në pikën 4, pas emërimit “Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar” shtohen fjalët “... ose ekspertë të njohur nga KMR-ja ...”.



3. Në rubrikën “Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë, gjeneratorë / llambë me rreze X, instalim/mirëmbajtje”, në fjalinë e fundit të pikës 5, fjalët “... siç përcaktohet në faqen zyrtare ...” zëvendësohen me “... ose t’i referohen listës së ekspertëve të njohur nga KMR-ja.”.

II. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 32, datë 12.11.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË
RREGULLOREN “PËR PËRCAKTIMIN
E PROCEDURËS SË INSPEKTIMEVE,
SI NJË PROCES I RREGULLT
ADMINISTRATIV”, MIRATUAR ME
URDHRIN NR. 25, DATË 10.8.2018,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë

16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik ‘e-Inspektimi’”:

URDHËROJ:

1. Në rregulloren “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, miratuar me urdhrin nr. 25, datë 10.8.2018, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Në aneksin 1 të rregullores, formati standard nr. 11, ‘Vendim i Komisionit të Ankimit’, zëvendësohet me formatin standard me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij urdhri.”.

2. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe inspektoratet shtetërore dhe/ose strukturat përgjegjëse të inspektimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari



Formati nr. 11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX
DREJTORIA RAJONALE _____

VENDIMI
I KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKIMIT

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____

Emërtimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit _____

(emërtimi i inspektoratit shtetëror)

Emri i subjektit që është ankuar, të cilit i referohet vendimi përfundimtar (kjo pjesë plotësohet nga sistemi)

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. _____, datë _____, “Për krijimin dhe organizimin e ISH” dhe ankimit për vendimin përfundimtar nr. _____, datë _____, i subjektit _____ (emërtimi i subjektit që është ankuar) (kjo pjesë plotësohet nga sistemi).

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë _____

(shpjegimi i fakteve që janë bërë shkak për vendosje të dënimit administrativ/citimi i dënimit kryesor dhe plotësues sipas vendimit përfundimtar të inspektimit kundër të cilit është bërë ankimi), Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit arsyeton _____

Në konkluzion, Komisioni i Ankimit, pasi shqyrtoi ankesën e subjektit, si dhe morri në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e dorëzuar pranë _____

(emërtimi i inspektoratit shtetëror)

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit për vendimin përfundimtar ☐
2. Shfuqizimin e vendimit përfundimtar dhe pranimin e ankimit për vendimin përfundimtar ☐



3. Ndryshimin e vendimit përfundimtar, duke pranuar pjesërisht ankimin për vendimin përfundimtar ☐

4. Mospranimin e ankimit ☐

(Në printim të shfaqet vetëm opsioni që ka vendosur Komisioni i Shqyrtimit të Ankimit)

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKIMIT

(sipas VKM-së për krijimin e ISH-së)

1. KRYETARI

(Nënshkrimi dhe vula e institucionit)

2. ANËTAR
(Nënshkrimi)

4. ANËTAR
(Nënshkrimi)

3. ANËTAR
(Nënshkrimi)

5. ANËTAR
(Nënshkrimi)

Kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.



UDHËZIM

Nr. 274, datë 16.5.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE,
AFATEVE, KRITEREVE DHE
DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM
PËR VERIFIKIMIN E PASTËRTISË SË
FIGURËS SË PUNONJËSVE TË
AGJENCISË KOMBËTARE TË
KONTROLLIT TË *CANNABIS*-it APO TË
SUBJEKTEVE TË LICENCUARA APO TË
LEJUARA, SI DHE TË KRITEREVE
ETIKO-PROFESIONALE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 6 dhe pikës 8, të nenit 8, të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”,

UDHËZOJMË:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Ky udhëzim përcakton procedurat, afatet, kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin e pastërtisë së figurës të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it (në vijim “Agjencia”), dhe punonjësve të subjekteve të licencuara apo lejuara, administratorin, përfshirë dhe pronarët/aksionarët e tyre, si dhe kriteret etiko-profesionale.

Neni 2

Subjekte të këtij udhëzimi janë:

1. Aplikantët/punonjësit e Agjencisë;
2. Pronarët/aksionarët, administratori dhe aplikantët/punonjësit e subjekteve të licencuara apo të lejuara.

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

1. Për vlerësimin dhe verifikimin e pastërtisë së figurës, Agjencia bashkëpunon me institucionet e

mëposhtme, të cilat janë përgjegjëse për verifikimet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë si vijon:

a) Policinë e Shtetit, për kriteret e parashikuara në pikën 1, germat “c”, “ç”, “d”, të nenit 5, të kreut II dhe në pikën 1, germat “c”, “ç”, “d”, të nenit 10, të kreut IV;

b) Agjencinë e Inteligjencës Financiare, për kriteret e parashikuara në pikën 1, germën “c” të nenit 5 të kreut II dhe në pikën 1, germën “c”, të nenit 10, të kreut IV;

c) Institutin e Mjekësisë Ligjore, për verifikimin e kriterit të mos përdorimit të drogave.

2. Me qëllim vlerësimin e pastërtisë së figurës dhe kryerjen e verifikimeve në lidhje me vetëdeklarimin e bërë nga aplikanti/punonjësi, Agjencia ka të drejtë të bashkëpunojë dhe me institucione të tjera, si:

a) Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore;

b) Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

c) gjykatat;

ç) prokuroritë;

d) autoritetet apo institucione të tjera përgjegjëse që mbajnë apo administrojnë të dhënat për këtë qëllim.

3. Agjencia dhe institucionet e sipërcituara dhe të përfshira në procesin e verifikimit, kanë detyrimin që gjatë procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës:

a) të ruajnë dinjitetin e personit që verifikohet;

b) të respektojnë parimin e ligjshmërisë, objektivitetit, balancimit të interesave dhe paanësisë, transparencës dhe profesionalizmit;

c) të mbrojnë të dhënat personale;

ç) të angazhojnë punonjës me përvojë në kryerjen e procedurave të verifikimit.

4. Periudha e vlerësimit për verifikimin e pastërtisë së figurës, për efekt të këtij udhëzimi, përfshin periudhën 5-vjeçare nga data e përcjelljes së kërkesës për verifikim dhe, nëse periudha është e pamjaftueshme, verifikimi fillon nga 18 vjeç;

5. Verifikimi i pastërtisë së figurës kryhet për të vlerësuar pastërtinë e figurës së kandidatit/ punonjësit dhe përfshin vlerësimin e vetë kandidatit/ punonjësit apo përfshirjen e tij në aktivitete të tjera në marrëdhënie me familjarët apo palë të treta të cilat mund të cenojnë pastërtinë e figurës së tij, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

6. Struktura përgjegjëse në Agjenci për realizimin e procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës është struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit. Në



rastet kur verifikimi kryhet për punonjësit e kësaj strukture, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë mund të përcaktojë punonjës të tjerë për kryerjen e këtyre detyrave.

KREU II

PROCEDURAT, AFATET, KRITERET DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR VERIFIKIMIN E PASTËRTISË SË FIGURËS SË PUNONJËSVE TË AGJENCISË

Neni 4

Procedurat dhe afatet për verifikimin e pastërtisë së figurës së punonjësve të Agjencisë

1. Agjencia publikon në faqen zyrtare (të Agjencisë dhe/ose të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë) datën e fillimit dhe të mbarimit të afatit të aplikimit, si dhe kriteret që duhet të plotësojë aplikanti dhe mënyrën e vlerësimit të aplikimeve. Thirrja për aplikim qëndron e afishuar për një periudhë 4-avore. Në raste të arsyetuara të nevojës për plotësimin e vendeve vakante thirrja mund të qëndrojë e shpallur dhe për periudha më të shkurtra, por jo më pak se 2 javë.

2. Personi aplikues jep pëlqimin me shkrim për mbledhjen dhe trajtimin të dhënave personale, si dhe për kryerjen e procedurave të verifikimit sipas parashikimeve në këtë udhëzim, duke plotësuar formularin e autorizimit dhe formularin e vetëdeklarimit, respektivisht sipas anekseve 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, dhe duke dorëzuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 6 të këtij kreu. Procesi i vlerësimit të kandidatit fillon vetëm pas dorëzimit nga personi aplikues të formularëve sipas anekseve 1 dhe 2, dhe dokumentacionit respektiv, me përjashtim të vërtetimit të përcaktuar në germën “e”, të pikës 1, të nenit 6, të këtij kreu, i cili dorëzohet në vijim të kryerjes së testit sipas njoftimit përkatës nga Agjencia. Dokumentacioni përkatës për verifikimin e pastërtisë së figurës dorëzohet nga personi aplikues në protokollin e Agjencisë dhe/ose adresën e postës elektronike sipas përcaktimit në shpallje, dhe më pas i përcillet menjëherë strukturës përgjegjëse për këtë qëllim në Agjenci.

3. Struktura përgjegjëse vlerëson rregullsinë e plotësimit të formularëve dhe dokumentacionit të paraqitur dhe në rast se konstatohen mangësi, kërkon plotësimin e dokumentacionit ose saktësimin e të dhënave të formularëve.

4. Vlerësimi i aplikantëve kryhet në dy faza nga një komision vlerësimi, i ngritur me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë, me të paktën 3 punonjës të Agjencisë:

a) Faza 1: Vlerësimi i kriterëve profesionale të aplikantit, i cili kryhet mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar për këtë qëllim dhe intervistës që kryhet nga komisioni i vlerësimit me aplikantin;

b) Faza 2: Vlerësimi i kriterëve të tjera të parashikuara në këtë udhëzim.

Vlerësimi i fazës së dytë kryhet vetëm për aplikantët të cilët janë përzgjedhur në fazën e parë bazuar në kriteret profesionale, si dhe për aplikantët në listën rezervë në renditjen e aplikantëve sipas vlerësimit në fazën e parë.

5. Formulari dhe dokumentacioni përkatës, shqyrtohet nga struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit të Agjencisë brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të tyre dhe, kur ai rezulton i plotë, përcillet nga Agjencia, në institucionet e parashikuara në pikën 1, germat “a” dhe “b”, të nenit 3, të kreut I të këtij udhëzimi, si dhe, sipas nevojës, në institucione të tjera të parashikuara në pikën 2, të nenit 3, të kreut I, të këtij udhëzimi.

6. Institucionet që marrin kërkesën për verifikim nisin menjëherë procedurat për kryerjen e verifikimeve përkatëse dhe i kthejnë përgjigje të specifikuar Agjencisë mbi rezultatet e verifikimit, sipas kriterëve specifike të përcaktuara në nenin 3, të kreut I, si dhe kërkesave të tjera specifike të përcjella nga Agjencia, jo më vonë se 30 ditë kalendrike nga depozitimi i kërkesës nga Agjencia.

7. Testi për mospërdorimin e drogave kryhet nga aplikanti/punonjësi në Institutin e Mjekësisë Ligjore brenda afateve të caktuara nga Agjencia dhe në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga njoftimi i tij në adresën elektronike që ai ka komunikuar për njoftimet zyrtare në formularin e aplikimit. Agjencia njofton Institutin e Mjekësisë Ligjore mbi datën kur do të kryhet testi nga aplikantët. Mos kryerja e testit nga aplikanti/punonjësi brenda datës së përcaktuar nga Agjencia për kryerjen e testit përbën shkak për refuzimin e aplikimit. Paga për testimin kryhet nga aplikanti/punonjësi me marrjen e njoftimit nga Agjencia për kryerjen e testit, në llogarinë bankare të Institutit të Mjekësisë Ligjore, sipas përcaktimeve në aneksin 3, të këtij udhëzimi.

8. Agjencia ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë apo të kryejë intervista me aplikantët apo punonjësit për të cilët kryhet verifikimi, kur gjatë



procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës është mbledhur informacion i pamjaftueshëm apo me përmbajtje kontradiktore, me ndikim të drejtpërdrejtë në vendimarrje.

9. Aplikantit/punonjësit i sqarohet arsyeja e thirrjes në intervistë dhe në bashkëpunim me të vendoset për kohën e kryerjes së intervistës jo më vonë se 5 ditë pune nga data e njoftimit. Mosparaqitja në intervistë brenda kësaj date, që nuk vjen si pasojë e pamundësisë objektive të aplikantit/punonjësit, përbën arsye të mjaftueshme për refuzimin e aplikimit. Në çdo rast mosparaqitja e kandidatit në intervistë brenda afatit prej 15 ditë pune nga data e njoftimit përbën shkak për refuzimin e aplikimit.

10. Struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit, për nevoja të verifikimit mund të thërrasë në intervistë edhe persona të tjerë, të cilët njohin të shkuarën dhe aktivitetet e aplikantit/punonjësit që i është nënshtruar verifikimit të pastërtisë së figurës, kur gjatë procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës është mbledhur informacion i pamjaftueshëm apo me përmbajtje kontradiktore, me ndikim të drejtpërdrejtë në vendimarrje.

11. Struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit shqyrton përgjigjet e përcjella jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga marrja e tyre dhe përgatit vendimin për kualifikimin ose jo të aplikantit, së bashku me një relacion për drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë me konkluzionet respektive për çdo individ të verifikuar. Nëse praktika e përcjellë ka mospërputhje apo është e paplotë, drejtori i përgjithshëm i kthen strukturës respektive praktikën për plotësim dhe/ose kryerjen e verifikimeve të mëtejshme.

12. Aplikanti që nuk plotëson kriteret, njoftohet me shkrim nga Agjencia për moskualifikimin ose mbi refuzimin e aplikimit. Punonjësi për të cilin është kryer verifikimi i pastërtisë së figurës dhe që ka rezultuar se nuk plotëson kriteret, njoftohet me shkrim nga Agjencia dhe fillon menjëherë procedura për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

13. Aplikanti/punonjësi ka të drejtë ankimi brenda 5 ditësh pune nga marrja e njoftimit, në përputhje me përcaktimet në Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi nuk pengon vijimin e procedurave të rekrutimit të punonjësve për pozicionet vakante, të cilët rekrutohen në mënyrë të përkohshme deri në daljen e një vendimi përfundimtar për ankimin. Në rastet kur verifikimi i kryer ka lidhje me një punonjës të

Agjencisë, dhe ky punonjës ka ankimuar vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të mosplotësimit të kriterëve për pastërtinë e figurës, ai pezullohet nga detyra deri në dhënien e një vendimi përfundimtar për ankimin, në përputhje me përcaktimet në Kodin e Procedurave Administrative. Agjencia shpall pozicionin vakant për rekrutim të stafit të ri, i cili qëndron në detyrë me afat deri në daljen e vendimit përfundimtar të ankimit të punonjësit të pezulluar. Në rast se vendimi përfundimtar vërteton se nuk plotësohet kriteri i pastërtisë së figurës për punonjësin ankimes, punonjësi që e ka zëvendësuar atë në mënyrë të përkohshme konsiderohet i punësuar definitiv në pozicionin përkatës.

14. Struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit në Agjenci kryen procedurat për verifikimin periodik të pastërtisë së figurës së punonjësve të saj, të paktën çdo 5 (pesë) vjet.

15. Përveç verifikimit periodik, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë urdhëron verifikimin e pastërtisë së figurës kur ka indicie ose dyshime që është cenuar pastërtia e figurës së punonjësve të saj.

Neni 5

Kriteret për pastërtinë e figurës që duhet të plotësojnë punonjësit e Agjencisë

Kriteret për pastërtinë e figurës që duhet të plotësojnë punonjësit e Agjencisë janë si më poshtë:

1. Për kriterin e integritetit moral:

a) të ketë integritet dhe figurë të pastër morale, si dhe besueshmëri profesionale;

b) të mos jetë në hetim apo i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për një vepër penale të kryer në fushën e narkotikëve, në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë, për vepra që kanë lidhje me integritetin dhe figurën morale, për pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal apo krim të organizuar;

c) të mos jetë pjesë e listës së personave të shpallur për vepra të terrorizmit apo financues të tij;

ç) të mos ketë apo të mos ketë pasur kontakte të papërshtatshme influencuese, së paku në 5 vjetët e fundit, me persona për të cilët ka qenë në dijeni se janë:

i. të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për një vepër penale të kryer në fushën e narkotikëve apo pjesëmarrje në krimin e organizuar;

ii. të konstatuar si përdorues të lëndëve narkotike nga Policia e Shtetit apo institucionet ligj zbatuese;



d) të mos ketë persona në përbërje të certifikatës familjare të individit që verifikohet, për të cilët ai ka dijeni se, së paku në 5 vjetët e fundit, janë:

i. në hetim apo janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një veprë penale në fushën e narkotikëve apo pjesëmarrje në krimin e organizuar;

ii. të konstatuar si përdorues të lëndëve narkotike nga Policia e Shtetit apo institucionet ligj zbatuese;

dh) të mos jetë përdorues i drogave (përfshirë dhe *cannabis*-in), të vërtetuar nga analizat e kryera pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore, dhe të kryejë testin përkatës kur i kërkohet gjatë fazës së aplikimit dhe verifikimit të pastërtisë së figurës, apo sa herë i kërkohet në kuadër të verifikimit periodik apo kur ka indicie për mosplotësim të kriterit të pastërtisë së figurës.

2. Për kriteret e veçanta etike:

Çdo punonjës i Agjencisë, pavarësisht pozicionit specifik të punës, duhet të plotësojë kriteret e veçanta etike, si më poshtë:

a) të mos ketë angazhime të tjera të cilat e vendosin në kushtet e konfliktit të interesit me detyrën që kryen, si dhe të deklarojë në formularin në aneksin 2 çdo veprimtari tjetër të tij apo aksione/pjesë që ai apo anëtarët e familjes së tij zotërojnë;

b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi për shkelje të etikës profesionale, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen, në:

i. ruajtjen e integritetit gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe gjatë jetës së tij private;

ii. sjelljen dinjitoze gjatë ushtrimit të detyrës;

iii. ndershmërinë profesionale dhe korrektesën gjatë ushtrimit të detyrës;

iv. përfitime personale, për vete, familjarët apo personat e lidhur, që vijnë si pasojë e ushtrimit të papërshtatshëm të detyrës.

Neni 6

Dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin e pastërtisë së figurës së punonjësve të Agjencisë

1. Aplikanti/punonjësi dorëzon pranë Agjencisë dokumentacionin e mëposhtëm me qëllim verifikimin e pastërtisë së figurës:

a) jetëshkrim i plotësuar në format *europass*;

b) formularët sipas anekseve 1 dhe 2 të këtij udhëzimi;

c) formularin e dekriminalizimit;

ç) fotokopje të kartës së identitetit;

d) certifikata përkatësisht të gjendjes familjare / personale;

dh) certifikatë të gjendjes gjyqësore;

e) vërtetim i Institutit të Mjekësisë Ligjore që certifikon që nuk është përdorues i drogave (përfshirë dhe *cannabis*-in), sipas përcaktimeve në pikën 7 të nenit 4 të këtij kreu.

2. Trajtimi i të dhënave personale dhe i informacioneve të grumbulluara gjatë procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke ruajtur konfidencialitetin gjatë kryerjes së këtij procesi.

KREU III

KRITERET PROFESIONALE PËR PUNONJËSIT E AGJENCISË

Neni 7

Kriteret profesionale për punonjësit e Agjencisë

1. Kriteret profesionale që duhet të plotësojë çdo punonjës i Agjencisë janë si më poshtë:

a) të ketë përfunduar arsimin në përputhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b) të ketë të paktën 1 vit përvojë pune profesionale, apo një përvojë pune më të gjatë sipas përcaktimeve në kriteret e veçanta profesionale të pozicionit të punës;

c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

ç) të zotërojë gjuhën e huaj apo kritere të tjera sipas përcaktimeve në kriteret e veçanta profesionale të pozicionit të punës.

2. Për pozicione specifike të punës, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë miraton kriteret e veçanta profesionale të cilat i përgjigjen nevojave dhe kërkesave të pozicionit të punës.

3. Verifikimi i plotësimit të kriterëve profesionale është parakusht për nisjen e procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës.

Neni 8

Dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin e kriterëve profesionale

1. Dokumentet të cilat duhet të paraqesin të gjithë aplikantët për punonjës në Agjenci, janë si më poshtë:



a) jetëshkrimin e plotësuar në formatin *europass*;
 b) fotokopje të kartës së identitetit;
 c) fotokopje të librezës së punës;
 ç) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 d) fotokopje të noterizuar të diplomës/kualifikimit, si dhe dokumentin e njësimt/njohjes në Republikën e Shqipërisë për diplomat/kualifikimet e përfituara jashtë vendit;

dh) çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

2. Për pozicione specifike të punës për të cilat aplikohen edhe kriteret e veçanta profesionale, Agjencia mund të kërkojë dokumentacion shtesë, të cilat i bëhen të njohura aplikantëve në momentin e shpalljes së konkursit.

KREU IV

PROCEDURAT, AFATET, KRITERET DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR VERIFIKIMIN E PASTËRTISË SË FIGURËS SË PUNONJËSVE TË SUBJEKTEVE TË LICENCUARA APO TË LEJUARA

Neni 9

Procedurat dhe afatet për verifikimin e pastërtisë së figurës së punonjësve, administratorit dhe pronarëve/aksionarëve të subjekteve të licencuara apo të lejuara

1. Subjekti dorëzon pranë Agjencisë, në kuadër të procesit të licencimit apo të lejimit, si dhe në kuadër të procesit të verifikimit periodik, apo kur i kërkohe nga Agjencia, të dhënat për pronarët/aksionarët, administratorin dhe punonjësit që parashikon të punësojë apo që janë të punësuar pranë tij (në vijim “aplikantët”), sipas parashikimeve në këtë udhëzim.

2. Aplikantët japin pëlqimin me shkrim për mbledhjen dhe trajtimin të dhënave personale, si dhe për kryerjen e procedurave të verifikimit sipas parashikimeve në këtë udhëzim, duke plotësuar formularin e autorizimit dhe formularin e vetëdeklarimit, respektivisht sipas anekseve 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, dhe duke dorëzuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 11 të këtij kreu. Procesi i vlerësimit të aplikantit fillon vetëm pas dorëzimit të formularëve sipas anekseve 1 dhe 2, dhe dokumentacionit respektiv, me përjashtim të vërtetimit të përcaktuar në germën “e” të pikës 1, të nenit 11, të kreut IV, i cili dorëzohet në vijim të

kryerjes së testit sipas njoftimit përkatës nga Agjencia. Dokumentacioni përkatës për verifikimin e pastërtisë së figurës dorëzohet nga subjekti në protokollin e Agjencisë, dhe më pas i përcillet menjëherë strukturës përgjegjëse për këtë qëllim në Agjenci.

3. Struktura përgjegjëse vlerëson rregullsinë e formularëve dhe dokumentacionit të paraqitur dhe në rast se konstatohen mangësi, kërkon plotësimin e dokumentacionit.

4. Vlerësimi i plotësimit të kriterëve të aplikantëve kryhet në dy faza:

a) vlerësimi i kriterëve profesionale të aplikantit;

b) vlerësimi i kriterëve të tjera të parashikuara në këtë udhëzim.

Vlerësimi i fazës së dytë kryhet vetëm për aplikantët, të cilët rezultojnë se plotësojnë kriteret profesionale në fazën e parë.

5. Formulari dhe dokumentacioni përkatës, shqyrtohet nga struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit të Agjencisë brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të tyre dhe, kur ai rezulton i plotë, përcillet nga Agjencia, në institucionet e parashikuara në pikën 1, germat “a” dhe “b” të nenit 3 të kreut I të këtij udhëzimi, si dhe, sipas nevojës, në institucione të tjera të parashikuara në pikën 2 të nenit 3 të kreut I të këtij udhëzimi.

6. Institucionet që marrin kërkesën për verifikim nisin menjëherë procedurat për kryerjen e verifikimeve përkatëse dhe i kthejnë përgjigje të specifikuar Agjencisë mbi rezultatet e verifikimit, sipas kriterëve specifike të përcaktuara në nenin 3 të kreut I, si dhe kërkesave të tjera specifike të përcjella nga Agjencia, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga depozitimi i kërkesës nga Agjencia.

7. Testi për mospërdorimin e drogave kryhet nga aplikantët në Institutin e Mjekësisë Ligjore brenda afateve të caktuara nga Agjencia dhe në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga njoftimi i tij dhe/ose subjektit aplikues në adresën elektronike që ai ka komunikuar për njoftimet zyrtare në formularin e aplikimit. Agjencia njofton Institutin e Mjekësisë Ligjore mbi datën kur do të kryhet testi. Mos kryerja e testit nga aplikanti brenda datës së përcaktuar nga Agjencia për kryerjen e testit përbën shkak për të konsideruar të paplotësuar kriterin e pastërtisë së figurës për këtë aplikant. Paga për testimin kryhet nga vetë aplikanti ose nga subjekti i licencuar apo lejuar, me marrjen e njoftimit nga Agjencia për kryerjen e testit, në llogarinë bankare të Institutit të Mjekësisë



Ligjore, sipas përcaktimeve në aneksin 3 të këtij udhëzimi. Për pronarët/aksionarët, administratorin apo punonjësit që janë shtetas të huaj me rezidencë jashtë vendit, të cilët e kanë të pamundur për arsye objektive kryerjen e testit sipas specifikimeve më sipër, testimi mund të kryhet në shtetin e tij të rezidencës, në një institucion homolog me Institutin e Mjekësisë Ligjore, sipas orientimeve të strukturës përgjegjëse për sigurinë e personelit në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore.

8. Agjencia ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë apo të kryejë intervista me aplikantët për t'u punësuar, për të cilët kryhet verifikimi, si dhe të thërrasë në intervistë edhe persona të tjerë të cilët njohin të shkuarën dhe aktivitetet e aplikantit që i është nënshtruar verifikimit të pastërtisë së figurës, kur gjatë procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës është mbledhur informacion i pamjaftueshëm apo me përmbajtje kontradiktore, me ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrje.

9. Aplikantit i sqarohet arsyeja e thirrjes në intervistë dhe në bashkëpunim me të vendoset për kohën e kryerjes së intervistës jo më vonë se 5 ditë pune nga data e njoftimit. Mosparaqitja në intervistë brenda kësaj date, që nuk vjen si pasojë e pamundësisë objektive të aplikantit, përbën arsye të mjaftueshme për refuzimin e aplikimit. Në çdo rast mosparaqitja e aplikantit në intervistë brenda afatit prej 15 ditë pune nga data e njoftimit përbën shkak për refuzimin e aplikimit.

10. Struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit shqyrton përgjigjet e përcjella jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga marrja e tyre dhe përgatit përgjigjen për subjektin dhe aplikantin, së bashku me një relacion për drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë me konkluzionet respektive për çdo individ të verifikuar. Nëse praktika e përcjellë ka mospërputhje apo është e paplotë, drejtori i përgjithshëm i kthen strukturës respektive praktikën për plotësim dhe/ose kryerjen e verifikimeve të mëtejshme.

11. Nëse aplikanti për të cilin është kryer verifikimi i pastërtisë së figurës ka rezultuar se nuk plotëson kriteret, Agjencia njofton me shkrim subjektin që ka përcjellë aplikimin dhe vetë aplikantin. Subjekti, me marrjen e njoftimit, është i detyruar t'i ndërpresë menjëherë marrëdhënien e punës, nëse ai është punonjës i këtij subjekti. Subjekti mund të plotësojë aplikimin me aplikantë të tjerë në zëvendësim të atyre që nuk kanë plotësuar kriteret, jo më vonë se 15 ditë

nga njoftimi i Agjencisë për mosplotësimin e kriterëve të aplikantit.

12. Subjekti/aplikanti kanë të drejtë ankimi brenda 5 ditësh pune nga marrja e njoftimit, në përputhje me përcaktimet në Kodin e Procedurave Administrative.

13. Strukturës përgjegjëse për sigurinë e personelit në Agjenci kryen procedurat për verifikimin periodik të pastërtisë së figurës së pronarëve/aksionarëve/administratorit/punonjësve e të subjekteve të licencuara apo të lejuara të paktën çdo 5 (pesë) vjet.

14. Përveç verifikimit periodik, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë urdhëron verifikimin e pastërtisë së figurës kur ka indicie ose dyshime që është cenuar pastërtia e figurës së pronarëve/aksionarëve/administratorit/punonjësve të subjekteve të licencuara apo të lejuara.

Neni 10

Kriteret për pastërtinë e figurës dhe ato etike që duhet të plotësojnë punonjësit dhe pronarët/aksionarët, administratorin e subjekteve të licencuara apo të lejuara

Kriteret për pastërtinë e figurës që duhet të plotësojë çdo punonjës, administrator dhe pronar / aksionar i subjekteve të licencuara apo të lejuara, janë si më poshtë:

1. Për kriterin e integritetit moral:

a) të ketë integritet dhe figurë të pastër morale, si dhe besueshmëri profesionale;

b) të mos jetë në hetim apo i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për një vepër penale të kryer në fushën e narkotikëve, në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë, për vepra që kanë lidhje me integritetin dhe figurën morale, për pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal apo krim të organizuar;

c) të mos jetë pjesë e listës së personave të shpallur për vepra të terrorizmit apo financues të tij;

ç) të mos ketë apo të mos ketë pasur kontakte të papërshtatshme influencuese, së paku në 5 vjetët e fundit, me persona për të cilët ka qenë në dijeni se janë:

i. të dënuar me vendim Gjykatë të formës së prerë, për një vepër penale të kryer në fushën e narkotikëve apo pjesëmarrje në krimin e organizuar;

ii. të konstatuar si përdorues të lëndëve narkotike nga Policia e Shtetit apo institucionet ligj zbatuese;



d) të mos ketë persona në përbërje të certifikatës familjare të individit subjekt i verifikimit, të cilët ai ka dijeni se, së paku në 5 vjetët e fundit, janë:

i. në hetim apo janë dënuar me vendim Gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale në fushën e narkotikëve apo pjesëmarrje në krimin e organizuar;

ii. të konstatuar si përdorues të lëndëve narkotike nga Policia e Shtetit apo institucionet ligj zbatuese;

dh) të mos jetë përdorues i drogave (përfshirë dhe *cannabis-in*), të vërtetuar nga analizat e kryera pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore, dhe të kryejë testin përkatës, kur i kërkohet, gjatë fazës së aplikimit dhe verifikimit të pastërtisë së figurës, apo sa herë i kërkohet në kuadër të verifikimit periodik, apo kur ka indicie për mosplotësim të kriterit të pastërtisë së figurës.

2. Për kriteret e veçanta etike:

Çdo punonjës, administrator dhe pronar / aksionar i subjekteve të licencuara apo të lejuara, pavarësisht pozicionit specifik të punës, duhet të plotësojë kriteret e veçanta etike, si më poshtë:

a) të mos ketë angazhime të tjera të cilat e vendosin në kushtet e konfliktit të interesit me detyrën që kryen, si dhe të deklarojë në formularin në aneksin 2 çdo veprimtari tjetër të tij apo aksione/pjesë që ai apo anëtarët e familjes së tij zotërojnë;

b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi për shkelje të etikës profesionale të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen, në:

i. ruajtjen e integritetit gjatë ushtrimit të detyrës si dhe gjatë jetës së tij private;

ii. sjelljen dinjitoze gjatë ushtrimit të detyrës;

iii. ndershmërinë profesionale dhe korrektesën gjatë ushtrimit të detyrës;

iv. përfitime personale, për vete, familjarët apo personat e lidhur, që vijnë si pasojë e ushtrimit të papërshtatshëm të detyrës.

Neni 11

Dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin e pastërtisë së figurës së punonjësve, administratorit dhe pronarëve/aksionarëve të subjekteve të licencuara apo të lejuara

1. Subjekti dorëzon pranë Agjencisë dokumentacionin e mëposhtëm për pronarët / aksionarët, administratori dhe kandidatët për t'u

punësuar/punonjësit e tij me qëllim verifikimin e pastërtisë së figurës:

a) jetëshkrimin të plotësuar në format *europass*;

b) formularët sipas anekseve 1 dhe 2 të këtij udhëzimi;

c) formularin e dekriminalizimit;

ç) fotokopje të kartës së identitetit;

d) certifikata, përkatësisht, të gjendjes familjare/ personale;

dh) certifikatë të gjendjes gjyqësore;

e) vërtetim i Institutit të Mjekësisë Ligjore që certifikon që nuk është përdorues i drogave (përfshirë dhe *cannabis-in*), sipas përcaktimeve në pikën 7, të nenit 9, të këtij kreu.

2. Trajtimi i të dhënave personale dhe i informacioneve të grumbulluara gjatë procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke ruajtur konfidencialitetin gjatë kryerjes së këtij procesi.

KREU V

KRITERET PROFESIONALE PËR PUNONJËSIT E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA APO TË LEJUARA

Neni 12

Kriteret profesionale për punonjësit e subjekteve të licencuara apo të lejuara

1. Kriteret profesionale që duhet të plotësojë çdo punonjës i subjekteve të licencuara apo të lejuara janë si më poshtë:

a) të ketë përfunduar arsimin përkatës sipas përcaktimeve në kriteret e licencimit/lejimit;

b) të ketë të paktën 1 vit përvojë pune profesionale, apo një përvojë pune më të gjatë sipas përcaktimeve në kriteret e veçanta profesionale të pozicionit të punës në kriteret e licencimit/lejimit.

2. Kriteret profesionale që duhet të plotësojë stafi i subjekteve të licencuara për kultivimin dhe/ose përpunimin e *cannabis-it* mjekësor, me përjashtim të punonjësve që operojnë në terren për procese bazike të punimit të tokës:

a) të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

b) të zotërojnë gjuhën e huaj apo kritere të tjera sipas përcaktimeve në kriteret e veçanta profesionale të pozicionit të punës;



c) të paktën dy punonjës të jenë të kualifikuar respektivisht, një në fushën e farmacisë dhe një në fushën e agroinxhinierisë, me përvojë pune jo më pak se 3 vjet në fushat respektive, një prej të cilëve të jetë punësuar si drejtues teknik;

ç) punonjësi përgjegjës për financat të disponojë një diplomë Master i Shkencave, niveli 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), në fushën e financave dhe një eksperiencë pune në këtë fushë për të paktën 3 vjet;

d) punonjësi përgjegjës për shënjimin dhe gjurmimin, të ketë një formim në shkenca informatike/ elektronikë, shkenca kompjuterike, shkenca matematike, shkenca fizike, shkenca kimike/ biologjike, farmaci, shkenca bujqësore / agroinxhinierike, financë/ shkenca ekonomike, shkenca juridike, shkenca inxhinierike;

dh) punonjësi përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë duhet të ketë eksperiencë pune në sektorin e ruajtjes dhe sigurisë prej të paktën 3 vjet;

e) punonjësi përgjegjës për marrëdhëniet me institucionet publike duhet të ketë kualifikim të paktën të nivelit 6 të KSHK-së (*bachelor*), në fushën e shkencave juridike.

3. Kriteret profesionale që duhet të plotësojë stafi i subjekteve të lejuara për kultivimin dhe/ose përpunimin e *cannabis*-it industrial, me përjashtim të punonjësve që operojnë në terren për procese bazike të punimit të tokës:

a) të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

b) të zotërojnë gjuhën e huaj apo kritere të tjera sipas përcaktimeve në kriteret e veçanta profesionale të pozicionit të punës;

c) të paktën një punonjës të jetë i kualifikuar në fushën e agroinxhinierisë, me përvojë pune jo më pak se 3 vjet në fushën përkatëse, i cili të jetë punësuar si drejtues teknik për subjektin;

ç) punonjësi përgjegjës për financat të disponojë një diplomë Master i Shkencave, niveli 7 i KSHK-së, në fushën e financave dhe një eksperiencë pune në këtë fushë për të paktën 3 vjet;

d) punonjësi përgjegjës për shënjimin dhe gjurmimin, të ketë një formim universitar të paktën të nivelit 6 të KSHK-së, në shkenca informatike/ elektronikë, shkenca kompjuterike, shkenca matematike, shkenca fizike, shkenca kimike/ biologjike, farmaci, shkenca bujqësore/ agroinxhinierike, financë/ shkenca ekonomike, shkenca juridike, shkenca inxhinierike;

dh) punonjësi përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë duhet të ketë eksperiencë pune në sektorin e ruajtjes dhe sigurisë prej të paktën 3 vjet;

e) punonjësi përgjegjës për marrëdhëniet me institucionet publike duhet të ketë kualifikim të paktën të nivelit 6 të KSHK-së (*bachelor*), në fushën e shkencave juridike.

4. Verifikimi i plotësimit të kriterëve profesionale është parakusht për nisjen e procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës.

Neni 13

Dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin e kriterëve profesionale

1. Dokumentet të cilat duhet të paraqesin të gjithë aplikantët për punonjës në subjektet e licencuara apo të lejuara, janë si më poshtë:

a) jetëshkrim të plotësuar në formatin *europass*;

b) fotokopje të kartës së identitetit;

c) fotokopje të librezës së punës;

ç) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

d) fotokopje të noterizuar të diplomës / kualifikimit, si dhe dokumentin e njësimit/njohjes në Republikën e Shqipërisë për diplomat/ kualifikimet e përfituara jashtë vendit;

dh) çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

2. Për pozicione specifike të punës për të cilat aplikohen edhe kritere të veçanta profesionale, Agjencia mund t'i kërkojë subjektit dokumentacion shtesë.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 14

Dispozitat kalimtare

1. Deri në ngritjen e strukturës përgjegjëse për sigurinë e personelit, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë përcakton punonjësit që do të kryejnë detyrat dhe funksionet e strukturës përgjegjëse për sigurinë e personelit që lidhen me zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Për rekrutimet fillestare të grupit të parë të punonjësve të Agjencisë, shpallja për vendet vakante mund të qëndrojë e afishuar në faqen zyrtare të



Agjencisë ose të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë për periudha më të shkurtra se 4 javë, por në çdo rast jo më pak se 1 javë. Komisioni i vlerësimit për rekrutimin e grupit të parë të punonjësve i ngritur nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë, në mungesë të stafit të Agjencisë, mund të ketë në përbërje të tij dhe anëtarë të grupeve të përbashkëta të punës të ngritur për hartimin e akteve nënligjore të ligjit nr. 61/2023, të cilët ftohen nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë për të qenë pjesë e këtij komisioni.

3. Për rekrutimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, deri në ngritjen e strukturave funksionale të Agjencisë, aplikantët e përzgjedhur mund të fillojnë marrëdhëniet e punës me kontrata pune të përkohshme dhe paralelisht vijohet me procesin e verifikimit të pastërtisë së figurës. Kontrata për këta punonjës lidhet me kusht përfundimin me sukses të procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi. Në rastet kur punonjësi do të rezultojë se nuk plotëson kriteret e pastërtisë së figurës, kontrata e punës ndërpritet menjëherë. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë përcakton, sipas nevojave dhe proceseve të punës së Agjencisë, kandidatët të cilët mund të fillojnë punën para përfundimit të verifikimit të pastërtisë së figurës. Në çdo rast, punonjësit që nuk kanë kaluar

procesin e verifikimit të pastërtisë së figurës, nuk mund të angazhohen në procesin e licencimit të subjekteve.

Neni 15

Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it, dhe institucionet e parashikuara në nenin 3 të kreut I për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Mos marrja e masave për zbatimin dhe ndjekjen e detyrimeve që përcaktohen në këtë udhëzim, përbën shkelje disiplinore për punonjësit e Agjencisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Albana Kociu

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

ANEKS NR. 1

DEKLARIM PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR MBLEDHJEN DHE TRAJTIMIN TË DHËNAVE PERSONALE, SI DHE PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT TË PASTËRTISË SË FIGURËS

Unë, _____, i biri/e bija _____ dhe i/e _____
i/e datëlindjes _____, lindur në _____, dhe banues në _____ më _____
, me kombësi _____ dhe shtetësi _____
aktualisht i/e punësuar pranë _____
me detyrë _____ me vullnetin tim të lirë

DEKLAROJ SE:

- Mbështetur në nenin 35, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,
- Të neneve 2, 5, 10, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Të ligjit nr. 61/2023 “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për verifikimin e pastërtisë së figurës së punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, apo të punonjësve të subjekteve të licencuara apo lejuara;
- Jap pëlqimin që të mbledhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit për verifikimin e pastërtisë së figurës nga autoritetet verifikuese të cilat janë të ngarkuara nga kuadri ligjor në fuqi për kryerjen e një detyre të tillë;
- Jap pëlqimin që të mbledhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit në sqarim të të dhënave të vetëdeklaruara në kuadër të verifikimit të pastërtisë së figurës;



- Jam dakord që të dhënat e mia personale të deklaruara në formular, të dhënat e mbledhura gjatë procesit të verifikimit për sa kohë jam në kushtet e nevojës për verifikimin e pastërtisë së figurës, të trajtohen nga personat përgjegjës për trajtimin e të dhënave personale për qëllimet e ligjshme në lidhje me kërkesën time për kontrollin e pastërtisë së figurës.

- Jam i ndërgjegjshëm që çdo deklaram i rremë ose mungesë e ndonjë fakti të rëndësishëm mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për të ndaluar procedurat e verifikimit të pastërtisë së figurës dhe mosplotësimin e kriterit të pastërtisë së figurës.

Tiranë, më _____

DEKLARUESI

(_____)

ANEKSI NR. 2
FORMULAR VETËDEKLARIMI

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emri: _____

Mbiemri: _____

Atësia/amësia: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Dokumenti i identifikimit
(një kopje bashkëngjitur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam:

☐ i/e padënuar. ☐ i/e dënuar

DEKLARUESI _____

Emër Mbiemër / Firmë

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT _____

Emër Mbiemër / Firmë / Vulë

Autorizim. Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga _____.

(Subjekti i autorizuar)

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues _____

Data e nënshkrimit _____

Shënim.

Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.



ANEKSI NR. 3

TË DHËNAT PËR PAGESËN E TESTIMIT QË KRYEN INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

Tarifa është e përcaktuar në përputhje me përcaktimet në pikën 9.b të tabelës së tarifave në urdhrin e përbashkët të ministrit të drejtësisë dhe ministrit të financave nr. 1331/1, datë 16.3.2006 dhe 1734/1, datë 23.3.2006 “Për miratimin e tarifave për veprimet dhe shërbimet që ofron Instituti i Mjekësisë Ligjore”.

Pagesa kryhet në një nga llogaritë bankare të mëposhtme duke specifikuar në pagesën e kryer referencën për kryerjen e testimit; “Pagesë për testim sipas pikës 9.b të tabelës së tarifës së shërbimeve të IML në udhëzimin përkatës”.

Nr.	Emërtimi i bankës	SWIFT/Numri i llogarisë	IBAN-et e të ardhurave të Thesarit Tiranë
1	Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA)	AAISALTR/1701007600000460	AL17 2031 0019 1701 0076 0000 0460
2	Banka Credins	CDISALTR/589007	AL32 2121 1016 0000 0000 0058 9007
3	Banka Amerikane e Investimeve	EMPOALTR/000035449	AL88 2101 1012 0000 0000 0003 5449
4	Pro Credit Bank	FEFAALTR/107701190001	AL73 2091 1108 0000 1077 0119 0001
5	Banka e Parë e Investimeve (FIB)	FINVALTR/43400020900256900	AL28 2151 1031 ALL5 3000 0025 6900
6	Banka Kombëtare Tregtare (BKT)	NCBAALTX/401279588OLTHESALLAL	AL91 2051 1014 0127 9588 OLTHE SALLA
7	Raiffeisen Bank	SGSBALTX/0104030780	AL22 2021 1013 0000 0001 0403 0780
8	Tirana Bank	TIRBALTR/0100320000100	AL80 2061 1004 0000 1003 2000 0100
9	Union Bank	UNALALTR/111100925160118	AL61 2141 1209 0111 1009 2516 0118
10	Intesa Sanpaolo Bank (Banka Amerikane)	USALALTR/2014730702	AL15 2081 1008 0000 0020 1473 0702

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë

